



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit me karakter profesional  
“Teknik në prodhime digjitale dhe software”  
i  
Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Barleti”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Alketa Grepcka

2. Dr. Adisa Daberdini

Qershor/ 2022

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 1

## TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

**Për programin e studimit me karakter profesional në “Teknik në prodhime digjitale dhe software”**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Barleti”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave të Aplikuara dhe Kompjuterike
3	Emërtimi i programit të studimit:	Program me karakter profesional në “Teknik në prodhime digjitale dhe software”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër nr. 489 datë 27.07.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Nuk ka
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditim i parë
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vjet
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 5
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit (2020- 2021):	8 PAE /1 PAK
18	Numri i studentëve (2018-2020) :	12 studentë
19	Komente / të tjera:	Për vitin akademik <b>2020-2021</b> dhe <b>2021- 2022</b> nuk ka patur studentë të regjistruar në këtë program studimi

## TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti "Barleti" mbart një eksperiencë në fushën e programeve mësimore që ofrohen në Republikën e Shqipërisë. Universiteti "Barleti" është institucion jopublik i Arsimit të Lartë krijuar dhe regjistruar bazuar në VKM nr. 571 datë 12.08.2005.

Programi i studimit me karakter profesional 2 vjeçar "Teknik në prodhime digjitale dhe Software" është hapur me urdhër të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë përmes Urdhrit nr. 489 datë 27.07.2018 dhe zhvillohet në Departamentin e Shkencave të Aplikuara dhe Kompjuterike.

GVJ konstaton që IAL Universiteti "Barleti" zotëron të gjithë kuadrin ligjor dhe strukturat drejtuese dhe mbështetëse për të garantuar një mirëfunksionim të programit të studimit.

GVJ konstaton që programi i studimit me karakter profesional në "Teknik në prodhime digjitale dhe Software" është organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite në përputhje me legjislacionin vendas dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program studimi ka një kohëzgjatje 2 vite dhe në total 120 kredite.

GVJ konstaton se programi "Teknik në prodhime digjitale dhe Software" nëpërmjet moduleve dhe lëndëve të ofruara synon marrjen e njohurive në sisteme të mirembajtjes së rrjeteve, aftësi praktike për të përdorur teknikat aktuale, aftësi dhe mjetet e nevojshme për praktikën e informatizimit, kreativitetit dhe inovacionit.

Programi studimit ofrohet në gjuhën shqipe, me 120 kredite, në 2 vite akademike, 4 (katër) semestra. Kreditet janë të llogaritura sipas sistemit ECTS. Veprimtaria akademike e këtij programi ka filluar në vitin akademik 2018-2019.

GVJ konstaton se dosja e plotë të programit të studimit përmban informacionet për ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe jashtë auditorit. Frekuentimi ndjekja e programit dhe mënyra e vlerësimit të dijeve përcaktohen në rregulloren e programit dhe syllabuset.

GVJ konstaton se programi i studimit ka përmbajtje didaktike dhe profesionale formuese dhe garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave që synon programi.

GVJ konstaton se veprimtaritë në këtë program mësimor konsistojnë në:

- ***Veprimtari në disiplina të formimit të përgjithshëm (bazë) (0%);***
- Veprimtari në disiplina të formimit karakterizues të programit të studimit (60%);
- Veprimtari në disiplina të formimit të ngjashme ose/dhe integruese me disiplinat karakterizuese kredite (10%);
- Veprimtari në disiplina të formimit plotësuese (30%);
- ***Detyrimet permbyllëse (0%).***

## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;**

Ky raport është përgatitur nga grupi i ekspertëve të jashtëm të përcaktuar me Urdhër Nr 19, datë 23.02.2022 të ASCAL, “Për përcaktimin e ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, akreditimin e programit të studimit me karakter profesional 2 vjeçar “Teknik në prodhime digjitale dhe software”, aplikuar nga Universiteti “Barleti”, Tirane dhe në zbatim të ligjit Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, ku janë përcaktuar kodi i cilësisë dhe standardet shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin e programeve profesionale.

Ekspertët fillimisht vlerësuan dokumentacionin e vetëvlerësimit të dorëzuar nga Institucioni, në kuadër të procedurës së aplikimit për akreditim të programit të studimit me karakter profesional në “Teknik në prodhime digjitale dhe Software”


Ekspertët sipas një axhende të hartuar në funksion të procesit të vlerësimit të programit të studimit kanë realizuar vizitat në datën 24 Mars 2022, në Institucionin e Arsimit të Lartë Universiteti “Barleti”, sipas veprimtarive të parashikuara në axhendë, në funksion dhe plotësim të procesit të vlerësimit të jashtëm nga ekspertët. Grupi i ekspertëve ka vijuar punën për hartimin e një raporti të integruar të vlerësimit të jashtëm të programit të studimit, bazuar në gjetjet dhe konstatimet e zbatimit të kriterëve të standarteve shtetërore të cilësisë nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Barleti”.

Ekspertët kanë hartuar edhe raportin bazuar në gjetjet dhe vizitën në institucion dhe kanë konkluduar vlerësimin e tyre duke dhënë edhe disa rekomandime të cilat janë reflektuar në fund të raportit bashkë me pikat e forta dhe të dobta të evidentuara në këtë proces.

Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Aviola Bardhi.

Më datë 15/06/2022, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 20/48 Prot., datë 15/06/2022, dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet, përmes AMS, më datë 20/06/2022 dhe me shkresë zyrtare Nr. 777 Prot., datë 17.06.2022.

IAL nuk ka komente mbi draftin, kështu drafti kthehet në raport final.



**Vlerësimi i Programit të Studimit me karakter profesional “Teknik në prodhime digjitale dhe software”**

**I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL**

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi me karakter profesional në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij dhe në përputhje me nevojat e kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Programi i studimit me karakter profesional “Teknik në Prodhime Digjitale dhe Software” ofrohet në përputhje me misionin , vizionin dhe shtyllat kryesore të shprehur në nenin 4,5 dhe 6 në Statut të UniBa [Ev.2_Statuti i UniBa]. UniBa synon të zhvillojë programe formuese dhe trajnuese si edhe të realizojë shërbime arsimore, sociale dhe kulturore në një perspektivë të gjerë evropiane dhe ndërkombëtare. Në këtë kuader ai ofron edhe programe studimi afatshkurtra për kualifikime dhe specializime ku përfshihet edhe programi i studimit i marre në shqyrtim [Ev.2_Statuti I UniBa, neni 7, pika 2 dhe 3].
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit duhet të përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe të demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Dokumenta bazë institucionale si Statuti përcaktojnë qartë drejtimit prioritar. Ne Statut, neni 6 dhe në Rregulloren e Institucionit neni 4 janë konsideruar 6 shtyllat kryesore të aktivitetit të UniBa:  a) Shtylla akademike e fokusuar në strukturën dhe ofertën akademike; b) Shtylla e Studentit në Qendër e fokusuar në veprimtarinë studentore dhe komunitare; c) Shtylla e Kërkimit të Aplikuar dhe Novacionit e fokusuar në veprimtarinë kërkimore - shkencore; d) Shtylla Korporative dhe Administrative e fokusuar në veprimtaritë me karakter administrative; e) Shtylla e Sipërmarrjes e fokusuar në veprimtaritë e sipërmarrjeve të ngritura nga ana e institucionit për përmbushjen e misionit të tij;  [Ev.2_Statuti i UniBa, neni 5; ev.5 – Rregullore e UniBa, neni 4].
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit, si dhe fushën akademike të njësisë kryesore/kolegjit profesional dhe atë të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit.	Programi i studimit “Teknik në Prodhime Digjitale dhe Software” ofrohet në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative i cili në përbërjen e tij ka tre departamente përkatësisht:  a. Departamenti i Shkencave të Aplikuara dhe Kompjuterike ( ku zhvillohet programi në shqyrtim); b. Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit; c. Departamenti i Industrisë Kreative;  Nga evidencat e paraqitura konstatohet që programi i marrë në shqyrtim organizohet nga Departamenti i Shkencave të Aplikuara dhe është vijim i programeve që ky departament ndërmerr në fushën e

	<p>informatikes dhe TIK. Konkretisht, Departamenti i Shkencave te Aplikuara dhe Kompjuterike ofron programe studimi në Bachelor “Informatikë e Aplikuara”, Mastër Profesional “Menaxhimi i Teknologjisë së Informacionit” dhe në vijim janë edhe dy programe profesionale pëkatësisht “Teknik për pajisje elektronike dhe TIK” dhe “Teknik në Prodhime Digjitale dhe Software” [evidence: <a href="http://ams.asc.al/ams/components/expertpanel/procedurat_timeline;">http://ams.asc.al/ams/components/expertpanel/procedurat_timeline;</a> Ev. 26_Të dhëna për nr. e programeve(Tab 3)]</p> <p>Departamenti i Shkencave të Aplikuara dhe Kompjuterike ka gjithashtu në perberjen e tij një staf të kualifikuar i cili mbart eksperiencë dhe është në përputhje me fushën e programit të studimit “Teknik në Prodhime Digjitale dhe Software”. <b>Për vitin akademik 2020-2021 ky department liston në përbërjen e tij 10 pedagogë PAE (4 Dr. 5 MSc. Dhe 1 MP) dhe 2 pedagogë PAK (1 Prof. Asoc dhe 1 MSc.),</b> ndërsa aktualisht për këtë vit akademik për programin e studimit “Teknik në Prodhime Digjitale dhe Software” është angazhuar një staf akademik përkatësisht <b>8 PAE (1 Dr. 6 MSc dhe 1 MP) dhe 1 PAK (1 Msc.)</b> [Ev. 23_Te Dhena Tabelore Personelit(Tab 1&amp; 2; Ev. 24_Personeli Akademik i PP_TPD(Tab 6.1)].</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Propozimi, hartimi dhe realizimi i programit të studimit me karakter profesional mbështetet në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.</p>	<p>Institucioni ka hartuar një studim të mirëfilltë tregu në momentin e aplikimit për hapjen e tij [Ev. 16_Studim Tregu, PP_TPD]. Në këtë studim janë bërë hulumtime të mjedisit të jashtëm global dhe kërkesave në nivel kombëtar në lidhje me fushën e teknologjisë së informacionit. Studimi është bazuar edhe në një pyetësor të ndërmarrë në 100 kompani private ku rezultatet statistikore kanë paraqitur ndër të tjera edhe kërkesën e tyre për staf të trajnuar në fushën e menaxhimit të infrastruktures TI dhe proceseve të softuerit. Nga data 27.07.2018 ku është bërë edhe zbardhja e urdhërit nga MAS, UniBa dhe Departamenti i Shkencave te Aplikuara dhe Kompjuterike nuk ka ndërmarrë studime të mëtejshme tregu. Në mënyre sporadike evidentojmë në “Analizën e Programit të Studimit me karakter profesional në: “Teknik ne prodhime digjitale dhe software”, paragrafin 4 që trajton tregun e punës për vitin 2021/2022, paragrafi 4 “Mundësitë e Punësimit” në “Planin Strategjik për Zhvillimin e Programit”, për të cilat konstatojmë se janë të paqarta dhe japin konkluzione mbi baza të cilat nuk janë konkretisht të matshme [Ev. 38_Analizë e PP_TPD, faqja 1; Ev. 4_Plani Strategjik për Zhv. e PP_TPD, faqja 1].</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Gjatë realizimit të programit të studimit, nga pranimi në diplomim dhe pas daljes së studentëve në punë, zhvillohen studime periodike mbi tregun e punës, ndryshimet përkatëse dhe punësimin e studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton mungesë të realizimit të studimit të tregut. Evidentojmë të dhëna statistikore në lidhje me numrin e studentëve të punësuar por nuk gjejmë dokumentacion në lidhje me studimet periodike që Departamenti i Shkencave te Aplikuara dhe Kompjuterike ndërmerr në këtë drejtim [Ev. 27.28_Regjistrimet, Ecuria, Nota Mesatare- tabela 22]. Në analizën e punës studimi i tregut është përgjithësues dhe aspak me hapa konkrete [Ev. 38_Analize e PP_TPD.pdf, faqja 2].</p>

<p><b>Kriteri 6.</b> Studimet paraprake dhe periodike të tregut të punës për programet me karakter profesional duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>GVJ konstaton një mungesë të perthithjes së mendimit të kompanive të biznesit dhe punëdhënësve për programin e studimit dhe përmirësimet që ai kërkon në përshtatje edhe me kërkesat e tregut ndonëse ekzistojnë bashkëpunime me kompani të biznesit dhe institucione shtetërore në drejtim të aftësimit praktik dhe profesional të studentëve dhe në mundësinë për hartimin e programeve dhe kurrikulave në perputhje me fushat specifike për organizimin e kualifikimeve, lektoriumeve, seminareve dhe kurseve trajnuese [Ev. 35_Raporti Periodik Analitik per Marreveshje Bashkepunimi- bashkepunimi me kompanine "UNIBA", faqja 2] . Bazuar për sa është theksuar edhe në kriterin 4 dhe 5 më sipër, <b>GVJ rekomandon:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Të bëhet një studim i mirëfilltë tregu të punës i cili do të evidentonte qartë kërkesat e kompanive të biznesit dhe institucioneve në lidhje me studentët e diplomuar në këtë program studimi. Rezultatet e një studimi tregu do të shërbejnë edhe si një shtysë për përmirësimin e programit të studimit dhe në rritjen e cilësisë dhe përmbajtjes së tij e cila do të sjelle në terma afatgjatë edhe një rritje të numrit të studentëve ku vlen të theksohet që për vitin akademik 2020-2021 dhe 2021-2022 ky program studimi nuk ka patur student.</i></li> </ul>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<p>X</p>	

<p><b>Standardi I.2</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit dhe me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, dhe në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>UniBa ka një strukturë të qarte organizative dhe institucionale ku detyrat dhe përgjegjësitë janë të mirëpërcaktuar në Statut dhe në Rregullore të Universitetit [Ev. 2_Statuti i UniBa.; Ev. 5_Rregullore e UniBa.]. Mbarëvatja dhe supervizimi i programit të studimit bëhet nga Departamenti i Shkencave të Aplikuara dhe Kompjuterike i cili funksionon mbi bazën e një rregullore të qarte dhe funksionale [Ev. 6a_Rreg_Fakulteti i SHAK.; Ev. 6b_Rreg_Dept SHAK]. GVJ konstaton një angazhim të stafit akademik në departamente të tjera duke sjelle një frymë bashkëpunimi dhe risie. [Ev. 23_Të Dhëna Tabelore Personelit(Tab 1&amp; 2)]. Bashkëpunimet janë të vazhdueshme dhe me njësite administrative si Sekretaria Mësimore, NJSBC, Zyra e Karrierës &amp; Alumni, biblioteka, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerezore etj. [takim me stafin akademik, takim me perfaqesues te NJSBC, vizite ne biblioteke etj].</p>

**Kriteri 2.** Për realizimin e objektivave të procesit mësimor, formimin teorik e praktik të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie afatgjata e të qëndrueshme bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, me punëdhënës vendës, aktorë të biznesit vendës dhe/ ose të huaj.

UniBa ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me kompani të biznesit dhe institucione shtetërore në drejtim të zhvillimit të praktikave profesionale, trajnimit dhe aftesimit më të mirë të studentëve. Për këtë program studimi, konkretisht për vitin 2019, Departamenti i Shkencave të Aplikuara dhe Kompjuterike paraqet bashkëpunime të ngushta me 3 kompani private të cilat operojnë në fushën e Teknologjisë së Informacionit (tabela 1 vijon më poshtë) ndërsa në kuadër të programeve që ky departament ofron në fushën e informatikës dhe TIK (1 program studimi BSc: Informatikë e Aplikuar dhe 1 program studimi MP: Menaxhimi i Teknologjisë së Informacionit) spektri i bashkëpunimit është më i gjerë [Ev. 35\_Raporti Periodik Analitik për Marrëveshje Bashkëpunimi. Ev. 32\_Institucionet Bashkëpunuese-PP\_TPD(Tab 5); Ev. 34\_Marrëveshje Bashkëpunimi për Praktikën Profesionale]. DSHAK kryen bashkëpunime edhe me institucione shtetërore dhe homologe ndonëse theksojmë që të dhënat e paraqitur nga institucioni i përkasin më shumë programit Bachelor në “Informatikë të Aplikuar” [Ev. 32\_Institucionet Bashkëpunuese-PP\_TPD(Tab 5)]

**Tabela 1:** Kompanite me të cilat DSHAK bashkëpunon ne kuadër të programit të studimit “Teknik në prodhime digjitale dhe software”,

Kompani/Institucion	Fusha e trajnimit	Numri i studentëve të trajnuar
“DITAK”shpk	Trajnim në fushën e informatikës, në gjuhën e programimit JAVA, trajnim i integruar ne JAVA	Nuk ka evidencë per numrin e studentëve
“SITEL” shpk	Zhvillimin e praktikave të studentëve pranë ambjenteve për punën shkencore si detyra/projekte kursi, mikroteza etj.	Nuk ka evidencë per numrin e studentëve
“UNIBA”	Shkëmbim përvoje me personalitete/ ekspertë të kompanisë	Nuk ka evidencë per numrin e studentëve

**Kriteri 3.** Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit

GVJ konstaton hartimin e një raporti në lidhje me bashkëpunimet në fushën e biznesit dhe institucioneve



harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	homologe. <i>Theksojmë që ka mungesë të numrit të studentëve përfitues për këtë program studimi. [Ev. 35_Raporti Periodik Analitik per Marrëveshje Bashkëpunimi.pdf]</i>		
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	Departamenti i Shkencave të Aplikuara dhe Kompjuterike bashkëpunon me institucione shtetërore dhe kompani biznesi për kryerjen e praktikave profesionale. Në këtë drejtim bashkëpunimi me kompaninë “STILE” sh.p.k, “Ditak”sh.p.k kanë qenë frytdhënës [Ev. 35_Raporti Periodik Analitik për Marrëveshje Bashkëpunimi; Ev. 34_Marrëveshje Bashkëpunimi për Praktikën Profesionale].		
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.	Gvj evidenton një punë të kryer nga Departamenti i Shkencave të Aplikuara dhe Kompjuterike në drejtim mbledhjes të të dhënave statistikore në lidhje me bashkëpunimet që kryhen në kuadër të zhvillimit të praktikave profesionale. Raporti i hartuar nga ky departament është tregues i monitorimit të studentëve të punësuar në këto kompani në fund të diplomimit të tyre. <i>GVJ nuk gjeti të dhëna në lidhje me punësimin e studentëve si output të kësaj procedure të ndjekur nga DSHAK [Ev. 35_Raporti Periodik Analitik për Marrëveshje Bashkëpunimi; Ev. 38_Analize e PP_TPD].</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>
			<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi I.3</b>	
<b>Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi dhe Kuadrin Evropian e Shqiptar të Kualifikimeve për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve janë të organizuara në lëndë/ module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	<p>Organizimi dhe funksioni i programit të studimit “Teknik në prodhime digjitale dhe software” është shprehur qartë në rregulloret bazë të institucionit [Ev. 5_Rregullore e UniBa.pdf – Kreu V; Ev. 6a_Rreg_Fakulteti i SHAK.- Kreu II; Ev. 6b_Rreg_Dept SHAK – Kreu III; Ev. 7_Rreg_PP - Prodhime Digjitale dhe Software].</p> <p>Programi studimit “Teknik në prodhime digjitale dhe software” është në përputhje me nivelin 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (e cila ka 8 nivele) (aprovuar me Ligjin Nr. 10247, datë 04.03.2010 “Për kornizën shqiptare të kualifikimeve”) dhe Ligjin Nr. 23/2018 Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Ligjin Nr. 10 247, Datë 4.3.2010, “Për Kornizën Shqiptare Të Kualifikimeve” [Ev. 7_Rreg_PP - Prodhime Digjitale dhe Softëare, neni 2, pika 1].</p> <p>Plani mësimor është miratuar në vitin 2018 dhe nuk ka pësuar ndryshime. Në takimet e zhvilluara u theksua nevoja për ndryshime në përmbajtjen e tij të cilat do të ishin evidente menjëherë pas procesit të</p>

	<p>akreditimit siç është edhe theksuar edhe në Manualin e Hartimit &amp; Ndryshimit të Programit Ekzistues [Ev. 13.52 Manuali i hartimit&amp;ndryshimit të prog. Ekzistuese; takim me stafin akademik; takim me shefin e departamentit DSHAK]. Plani mësimor është i ndërtuar bazuar në kuadrin ligjor dhe sipas përcaktimeve të dhëna në Rregulloren e UniBa dhe rregulloren e programit të studimit [Ev. 5_Rregullore e UniBa.; Ev. 6a_Rreg_Fakulteti i SHAK; Ev. 6b_Rreg_Dept SHAK.; Ev. 7_Rreg_PP - Prodhime Digjitale dhe Software]</p> <p>Mbështetur në rregulloren e programit dhe planin mësimor të tij programi i studimit “Teknik në prodhime digjitale dhe softëare” përmban 120 kredite, të cilat janë të llogaritura sipas sistemit ECTS. Një krediti të formimit i korrespondon 25 orë mësimore që përbëhen nga orë mësimore për transmetim dijesh në auditor (leksione, seminare, ushtrime, laboratore, etj.) Kohëzgjatja e tij normale është dy vite akademike dhe është i organizuar në lëndë të vlerësuara me kredite [Ev. 5_Rregullore e UniBa.pdf – Kreu V; Ev. 6a_Rreg_Fakulteti i SHAK.- Kreu II; Ev. 6b_Rreg_Dept SHAK – Kreu III; Ev. 7_Rreg_PP - Prodhime Digjitale dhe Software];</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve me karakter profesional synojnë përfitim të njohurive gjithë përfshirëse të specializuara teorike dhe praktike brenda një fushe punësimi në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Programi i studimit “Teknik në prodhime digjitale dhe software” është ndërtuar dhe vënë në funksion nga UniBa për të dhënë njohuri profesionale dhe aftësi praktike në fushën e IT-së.</p> <p>GVJ konstaton një harmonizim midis kuadrit teorik dhe praktikës të zhvilluar [Ev. 14_Plan Mesimor_PP TPD.; Ev. 19_Syllabuse-PP_TPD]. Programi mësimor synon aftësimin e studentëve përmes ofrimit të praktikës në varietet formash përmendim orë laboratorikë, praktikë semestrale (6 ECTS) [takim me stafin akademik, takim me studentët].</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit me karakter profesional synojnë pajisjen e studentëve me një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse që nevojiten për të zgjidhur në mënyrë krijuese probleme të karakterit profesional praktik.</p>	<p>Programi i studimit ka një ndërthurje të kuadrit teorik me praktik duke garantuar që në fund të studimit studentit të zotërojë teknologji bashkëkohore dhe të pajiset me njohuri plotësuese në drejtime të veçanta sipas kërkesave të zhvillimit përmes lëndëve me zgjedhje të cilat plotësojnë këtë spekter të plotë të studimeve të tij. GVJ gjeti një konkretizim të objektivit të përcaktuar në rregulloren e programit mësimor (neni 3 pika a, b dhe e) me përmbajtjen e planit mësimor [Ev. 7_Rreg_PP - Prodhime Digjitale dhe Softëare; Ev. 14_Plan Mesimor_PP TPD].</p> <p>Programi i studimit “Teknik në prodhime digjitale dhe software” është ndërtuar në katër grup lëndë të cilat pajisin studentin me njohuri teorike dhe praktike. Konkretisht në planin mësimor në vitin e parë studentit merr njohuri në dy grup lëndë të rëndësishme:</p> <p><b>Viti I:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a. Dizajn digjital &amp; interaktiv (18 ECTS)</li> <li>b. Dizajn grafik &amp; animacion (18 ECTS)</li> </ul>

	<p>ndërsa në vitin e dytë studenti ka mundësinë të aftësohet në elemente programimi dhe softëere bazuar në dy grup lëndë të rëndësishme si vijon më poshtë:</p> <p><b>Viti II:</b></p> <p>a. Elemente programimi software (18 ECTS);</p> <p>b. Software per industri prodhuese (18 ECTS)</p> <p>Në çdo semester është përcaktuar edhe trajnimi praktik i vlerësuar me 6 ECTS.</p>																																						
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit me karakter profesional synojnë zhvillimin e kompetencave për menaxhimin dhe mbikëqyrje në kuadrin e veprimtarive profesionale dhe orientimin e duhur në situata të ndryshme e të ndryshueshme.</p>	<p>Në çdo semester janë vendosur edhe 2 lëndë me zgjedhje të cilat i përkasin në vit të parë fushës së gjuhës se huaj kryesisht anglisht ose gjermanisht dhe “Etika në pune dhe komunikim”, ndërsa në vitin e dytë është shtuar edhe lënda me zgjedhje “TIK në shkolla dhe shoqëri” dhe “Menaxhimi i proceseve te punes” secila me 3 ECTS.</p> <p><i>Ev. 14_Plan Mesimor_PP TPD.;</i></p>																																						
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni/ njësia kryesore/ kolegji profesional dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë të organizimit, strukturës akademike dhe numrit e shkallës së kualifikimit të stafit akademik.</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional në “Teknik në prodhime digjitale dhe software” mbulohet nga lektorë me tituj dhe grada në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe aktet e tij mbështetëse. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative pranë UniBa ka në përbërje të tij tre departamente: Departamenti i Shkencave të Aplikuara dhe Kompjuterike, Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit dhe Departamenti i Industrive Kreative.</p> <p><i>Tabela nr.2: Numri i personelit akademik dhe titujt/gradat:</i></p> <table border="1" data-bbox="596 1160 1343 1550"> <thead> <tr> <th rowspan="2"></th> <th colspan="2">Numri i PAE</th> <th rowspan="2">Gj</th> <th colspan="2">Numri i PAK</th> <th rowspan="2">Total</th> </tr> <tr> <th>Gj</th> <th>Tituj/Grada</th> <th>Gj</th> <th>Tituj/Grada</th> <th>Gj</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td rowspan="8"><b>Departamenti i Shkencave të Aplikuara dhe Kompjuterike (2020-2021)</b></td> <td rowspan="8">10</td> <td>(0) Prof. Dr.</td> <td rowspan="8">2</td> <td>(..) Prof. Dr.</td> <td rowspan="8">12</td> </tr> <tr> <td>(0) Prof. Asoc. Dr.</td> <td>(1) Prof. Asoc. Dr.</td> </tr> <tr> <td>(4) Dr.</td> <td>(0) Dr.</td> </tr> <tr> <td>(0) Dr.proc.</td> <td>(..) Dr.proc.</td> </tr> <tr> <td>(5) MSc.</td> <td>(1) MSc.</td> </tr> <tr> <td>(1) MP</td> <td></td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table> <p>Per programin e studimit me karakter profesional “Teknik në Prodhime Digjitale dhe Software” jane angazhuar stafi akademik si vijon më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="596 1720 1308 1868"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2020-2021</td> <td>1 Dr, 6 Msc.</td> <td>1 MSc.</td> </tr> </tbody> </table>		Numri i PAE		Gj	Numri i PAK		Total	Gj	Tituj/Grada	Gj	Tituj/Grada	Gj	<b>Departamenti i Shkencave të Aplikuara dhe Kompjuterike (2020-2021)</b>	10	(0) Prof. Dr.	2	(..) Prof. Dr.	12	(0) Prof. Asoc. Dr.	(1) Prof. Asoc. Dr.	(4) Dr.	(0) Dr.	(0) Dr.proc.	(..) Dr.proc.	(5) MSc.	(1) MSc.	(1) MP						Viti akademik	PAE	PAK	2020-2021	1 Dr, 6 Msc.	1 MSc.
	Numri i PAE		Gj	Numri i PAK		Total																																	
	Gj	Tituj/Grada		Gj	Tituj/Grada		Gj																																
<b>Departamenti i Shkencave të Aplikuara dhe Kompjuterike (2020-2021)</b>	10	(0) Prof. Dr.	2	(..) Prof. Dr.	12																																		
		(0) Prof. Asoc. Dr.		(1) Prof. Asoc. Dr.																																			
		(4) Dr.		(0) Dr.																																			
		(0) Dr.proc.		(..) Dr.proc.																																			
		(5) MSc.		(1) MSc.																																			
		(1) MP																																					
Viti akademik	PAE	PAK																																					
2020-2021	1 Dr, 6 Msc.	1 MSc.																																					

	1 MP	
2019-2020	1 Dr. 6 MSc. 1 MP	4 MSc.
2018-2019	3 Msc.	1 PhD ne proces 4 MSc.

- GVJ konstaton se grada shkencore e stafit akademik është në përputhje me kuadrin ligjor për mesimdhënien në programet me karakter profesional. Gjatë tre viteve akademike konstatojmë një rritje të stafit akademik për këtë program studimi.
- Në vitin 2018-2019 numri i stafit akademik me grada shkencore është i ulët (3 Msc) kundrejt viti 2020-2021 ku evidentojmë 6 MSc;
- GVJ konstaton një rritje të stafit akademik PAE nga viti 2018 (3 personal akademik) në 2021 (8 personel akademik) duke sjellë edhe reduktim të stafit PAK.

**Kriteri 6.** Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.

Programi i studimit ka të përcaktuar objektivat që lidhen me formimin profesional të studentëve, aftësitë dhe kompetencat profesionale që ata përfitojnë në përfundim të studimeve dhe çdo karakteristikë tjetër që lidhet me profilin profesional të programit. Regullorja e programit mësimor dhe dokumentat e tjerë ndihmës institucional faktojnë për objektiva të qarta dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës [Ev. 5\_Rregullore e UniBa; Ev. 6a\_Rreg\_Fakulteti i SHAK.; Ev. 6b\_Rreg\_Dept SHAK; Ev. 7\_Rreg\_PP - Prodhime Digjitale dhe Software].

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

### Standardi II.1

Programet e studimeve me karakter profesional janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të këtij niveli dhe mundësitë e punësimit

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit të ciklit të parë, përmbajnë dhe japin informacionet e nevojshme për objektivat formues, rezultatet e pritshme të të nxënësit, organizimin, strukturën, përmbajtjen, fushat e mundshme të punësimit apo të dhëna reale të punësimit të studentëve të diplomuar në këto programe.</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional “Teknik në prodhime digjitale dhe software” vihet në zbatim bazuar në rregulloren e tij. Kjo rregullore përmes dispozitave ligjore të saj përcakton qartë si vijon më poshtë;</p> <p><b>Neni 2 dhe 3:</b> Përshkrim të programit dhe objektivi i tij i cili synon në realizimin e një programi që synon pajisjen e studenteve me njohuri bazë në fushën e animacionit 2 D dhe 3D si edhe të dizajnit dixhital;</p> <p><b>Kreu II</b> i cili përcakton qartë organizimin e studimeve duke i dhënë mundësi studentëve të marrin informacion në lidhje me afatin dhe të drejtat e tyre në drejtim të frekuentimit dhe përfundimit të studimeve.</p> <p><b>Neni 9:</b> Përcakton edhe Planin mësimor (Curricula) ndërtimin dhe përmantjen e tij të cilën GVJ e gjen në akordancë me kornizën ligjore në fuqi. Format e mësimit të përshkruar qartë në nenin 11 të kësaj rregullore janë zbatuar me korrektesi. Takimet me stafin akademik dhe studentët dëshmuar për larminë e organizimit të veprimtarisë mësimore (në kushtet normale dhe gjatë periudhës së pandemisë shkaktuar nga COVID-19). Leksionet, seminarët, detyra kursi dhe praktikat lëndore dhe semestrale janë zbatuar në tërësinë e programit mësimor [takim me studentët, takim me stafin akademik, Ev. 7_Rreg_PP - Prodhime Digjitale dhe Softëare, neni 9]</p> <p><b>GVJ</b> gjen në aneksin 1 të kësaj rregullore përmbajtjen e programit mësimor të cilën e konsideron të zbatuar me korrektesi me programin mësimor të paraqitur nga institucioni si evidencë nr.14 [Ev. 7_Rreg_PP - Prodhime Digjitale dhe Softëare, Ev. 14_Plan Mësimor_PP TPD].</p> <p><b>Neni 30</b> në këtë rregullore përcakton edhe përgjegjësitë e UniBa për shpërndarjen e informacionit të nevojshëm në lidhje me planin mësimor, programet e lëndëve, rregullat e vlerësimit, rregullat e praktikës dhe rregullat në lidhje me diplomimit të tyre [Ev. 7_Rreg_PP - Prodhime Digjitale dhe Softëare, neni 30].</p> <p>Rezultatet e pritshme të të nxënësit janë të shprehur në çdo syllabus pjesë përbërëse e programit mësimor [Ev.</p>

	<p><i>19_Syllabuse-PP_TPD].</i></p> <p>Fushat e punësimit të studentëve janë të shprehur në Rregulloren e DSHAK ndërsa mundësitë për një punësim të tyre janë pjesë e veprimtarisë së Qendrës së Karrieres &amp; Alumni. Të dhënat në lidhje me punësimin e tyre mbahen nga kjo zyrë, ndonëse në raportin e paraqitur si evidencë Ev. 55_Raporti-Alumni-te-dhenat-statistikore, GVJ nuk gjeti të dhëna në lidhje me punësimin e studentëve të diplomuar nga ky program studimi sipas fushës së diplomimit të tyre dhe në analizën e tij u bazua vetëm në të dhënat përmbledhëse statistikore të shprehur në evidencën nr.59 [Ev. 59_Tab përmbledhëse për Aneks_RVB]</p>																								
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit janë të organizuara në module/ lëndë e aktivitete formuese, të vlerësuara me kredite, të ndara në vite e semestra e që janë në përputhje me përcaktimet vendëse e evropiane në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional “Teknik në prodhime digjitale dhe software” zhvillohet në dy vite akademike me një total 120 ECTS. Natyra e lëndëve mësimore pjesë e programit mësimor përcaktohet qartë në nenin 15 të Rregullores. Lëndët në këtë program janë grupuar në katër kategori kryesore;</p> <p>B. Lëndë Karakterizuese</p> <p>C. Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese</p> <p>D. Lëndë plotësuese</p> <p>[Ev. 7_Rreg_PP - Prodhime Digjitale dhe Softëare, Ev. 14_Plan Mësimor_PP TPD].</p> <p>Konkretisht në këtë program studimi GVJ bazuar edhe në VKM Nr.879 date 18.12.2019 konstaton si vijon më poshtë përqindjen e lëndëve në secilen kategori:</p> <p>Tabela nr.3: Përqindja e lëndëve sipas kategorive;</p> <table border="1" data-bbox="673 1243 1353 1758"> <thead> <tr> <th>Kategoria</th> <th>Tipi</th> <th>IAL</th> <th>Standardi</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td><b>A</b></td> <td><b>Lëndë Bazë</b></td> <td><b>0%</b></td> <td><b>10-15 % (kredite)</b></td> </tr> <tr> <td><b>B</b></td> <td><b>Lëndë karakterizuese</b></td> <td><b>60 %</b></td> <td><b>45- 55 % (kredite)</b></td> </tr> <tr> <td><b>C</b></td> <td>Lëndë ndërdisiplinore / integruese</td> <td>10 %</td> <td>5-15% (kredite)</td> </tr> <tr> <td><b>D</b></td> <td><b>Lëndë plotësuese</b></td> <td><b>30 %</b></td> <td><b>10 – 15 % (kredite)</b></td> </tr> <tr> <td><b>E</b></td> <td><b>Detyrime përmblyëse</b></td> <td><b>0 %</b></td> <td><b>3 – 5 % (kredite)</b></td> </tr> </tbody> </table> <p>• GVJ gjeti një mospërputhje midis kategorive të përcaktuara në VKM Nr. 879 datë 18.12.2019,</p>	Kategoria	Tipi	IAL	Standardi	<b>A</b>	<b>Lëndë Bazë</b>	<b>0%</b>	<b>10-15 % (kredite)</b>	<b>B</b>	<b>Lëndë karakterizuese</b>	<b>60 %</b>	<b>45- 55 % (kredite)</b>	<b>C</b>	Lëndë ndërdisiplinore / integruese	10 %	5-15% (kredite)	<b>D</b>	<b>Lëndë plotësuese</b>	<b>30 %</b>	<b>10 – 15 % (kredite)</b>	<b>E</b>	<b>Detyrime përmblyëse</b>	<b>0 %</b>	<b>3 – 5 % (kredite)</b>
Kategoria	Tipi	IAL	Standardi																						
<b>A</b>	<b>Lëndë Bazë</b>	<b>0%</b>	<b>10-15 % (kredite)</b>																						
<b>B</b>	<b>Lëndë karakterizuese</b>	<b>60 %</b>	<b>45- 55 % (kredite)</b>																						
<b>C</b>	Lëndë ndërdisiplinore / integruese	10 %	5-15% (kredite)																						
<b>D</b>	<b>Lëndë plotësuese</b>	<b>30 %</b>	<b>10 – 15 % (kredite)</b>																						
<b>E</b>	<b>Detyrime përmblyëse</b>	<b>0 %</b>	<b>3 – 5 % (kredite)</b>																						

	<p>kategorive të përcaktuar edhe në rregulloren e programit mësimor dhe ndarjes së tyre në këtë program. <i>Nga tabela nr. 3 evidentojmë një mungesë të lëndëve të formimit bazë të cilat ndonëse në rregulloren e programit përcaktojnë qartë që keto grup lëndësh japin një formim të përgjithshëm, përgatitje metodologjike të studentit në këtë program mungojnë.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Peshë e lëndëve të përfshira në <i>kategorinë B tejkalon masën e përcaktuar edhe në VKM Nr.879</i>. Kufiri është 45-55% ndësa kjo kategori zë një masë 60% .</li> <li>• Lëndë plotësuese (<i>kategoria "D"</i>) e cila sipas <i>standartit duhet të jetë 5-15% ndërsa në këtë program zë peshën 30%</i>. Në këtë veprimtari formuese është përfshirë edhe Trajnimi Praktik i cili zhvillohet në çdo semestër dhe vlerësuar me 6 ECTS.</li> <li>• <i>GVJ gjeti një përsëritje të lëndëve në kategori "C" dhe "D" për të dy vitet pa krijuar një diversitet midis vitit të parë dhe të dytë</i>. Konkretisht gjuhë e huaj (anglisht ose gjermanisht) bëhet në vitin e parë dhe të dyte akademik, lënda "Punë në grup dhe komunikimi"/ "Etika në grup dhe komunikimi" përsëritet deri në semestrin e parë të vitit të dytë.</li> <li>• Bazuar edhe në VKM nr.897 datë 1812.2019 dhe VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 për "Elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" <i>GVJ i gjen jo koherente vendosjen e lëndëve "Punë në grup dhe komunikimi"/ "Etika në grup dhe komunikimi" në kategorinë "C"</i> .</li> <li>• GVJ konstaton që programi nuk përmban detyrime përmblyese, kategoria "E". Ndonëse në nenin 9 të rregullores së programit mësimor citojmë: "<i>Plani mësimor (curricula) përfshin lëndën mësimore, praktikën dhe provimin final. Plani mësimor ndërtohet mbi disa blloqe kryesore: lëndë bazë, lëndë karakterizuese, lëndë ndërsiplinore/integruese, lëndë plotësuese dhe detyrime përmblyese</i>", <i>GVJ nuk gjen përfshirjen e veprimtarisë formuese "Detyrime përmblyese" në programin mësimor.</i></li> </ul> <p><i>Per sa me sipër GVJ gjen një mos – akordancë midis lëndëve në programin mësimor dhe përcaktimeve të dhëna nga korniza ligjore ( VKM nr.897 datë 1812.2019 dhe VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 për "Elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë").</i></p> <p>GVJ gjen një mos – akordancë midis lëndëve në programin mësimor dhe përcaktimeve të dhëna nga korniza ligjore (VKM</p>
--	---

	<p>nr.897 datë 1812.2019 dhe VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 për “Elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”). GVJ rekomandon një rishikim të programit mësimor, një shpërndarje të drejtë të lëndëve sipas kategorive të veprimtarive formuese. <b>GVJ rekomandon:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Përfshirjen në programin mësimor të kategorive “A” dhe “E” dhe reflektimin e tij edhe në Rregulloren e Programit mësimor nga ana e DSHAK.</b></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit, vlerësimin e dijeve, aktivitete specifike etj.</p>	<p>Plani mësimor i programit profesional “Teknik në prodhime digjitale dhe software” është i ndarë në katër semestra dhe ka të gjitha informacionet e nevojshme që lidhen me lëndët për çdo semestër, pedagogun përgjegjës për këtë lëndë, ngarkesën mësimore, aktiviteteve formuese, orët në auditor, ndarjen e orëve të leksionit dhe semestrave, kreditet e gjithashtu orët e studimit.</p> <p>Bazuar në planin mësimor por edhe në planin programin e lëndëve, vërehet se secila lëndë ka të përcaktuar qartë objektivat formuese, ngarkesën e parashikuar për studentët si në auditor ashtu edhe punim individual. GVJ konstaton se institucioni përdor një metrikë të njëjtë në vlerësimin e ngarkesës në auditor për kredit për lëndë, së paku për lëndë të njëjtës kategori.</p> <p>[Ev. 19_Syllabuse-PP_TPD; Ev. 14_Plan Mesimor_PP TPD.]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikën, ushtrimet apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët e aktiviteteve formuese të programit të studimit.</p>	<p>Çdo lëndë e programit të studimit profesional “Teknik në prodhime digjitale dhe software” ka syllabusin e detajuar sipas Udhëzimeve të MASR [VKM nr.897 date 1812.2019 dhe VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 për “Elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”]. Syllabuset për çdo lëndë, pasqyrojnë këta elementë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Emërtimi i lëndës/modulit;</i></li> <li>▪ <i>Viti/semestri kur zhvillohet lënda;</i></li> <li>▪ <i>Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën;</i></li> <li>▪ <i>Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë;</i></li> <li>▪ <i>Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik;</i></li> <li>▪ <i>Ngarkesa në orë në auditor si dhe në ECTS;</i></li> <li>▪ <i>Format e vlerësimit të studentëve dhe raportet midis tyre;</i></li> <li>▪ <i>Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse.</i></li> </ul> <p>Format e vlerësimit të studentëve në syllabus zënë peshën:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Pjesëmarrje aktive: 10%</i></li> </ul>



- *Praktikë: 40%*
- *Presantim: 10%*
- *Provimi përfundimtar: 40 %*

ndërsa gjejmë të aprovuar komponentët e vlerësimit si vijon më poshtë:

- *Provimi i ndërmjetëm: 20%*
- *Pjesëmarrja dhe aktivizimi: 10%*
- *Detyra kursi: 20%*
- *Provimi përfundimtar: 50%*

[Ev. 59\_Tab permbledhese per Aneks\_RVB]

Bazuar në nenin 85 të Rregullores së UniBa “.. çdo formë vlerësimi e shprehur në syllabus është e miratuar nga departamenti..” GVJ konsideron të mirëqënë këtë mos-akordancë midis formës së vlerësimit të paraqitur nga Institucioni në evidencen nr. 59 dhe formave të vlerësimit të gjetur në syllabuse [Ev. 59\_Tab permbledhese per Aneks\_RVB; Ev. 5\_Rregullore e UniBa, neni 85].

Përrjashtim ka bërë vetëm lënda “Photoshop & Dizajni Dixhital” e cila në vlerësimin e saj bazohet në testet e ndërmjetme, detyrat e kursit/projeket e kursit dhe i jep një peshe 40%, pjesëmarrjes aktive 10% dhe provimit përfundimtar 50%.

GVJ shqyrtoi me vemendje syllabuset e paraqitura nga Institucioni. GVJ konstaton se :

- Syllabuset për lëndët gjuhë e huaj “Anglisht” janë dhënë vetëm për semestrin e I dhe të II (përmbledhur bashkë) ndërsa mungojnë për vitin II.
- Syllabusi për gjuhë te huaj “Gjermanisht” është dhënë për semestrin e 2-të/Viti I ndërsa mungojnë për semestrat e tjerë.
- GVJ konstaton edhe mungesë të syllabuseve për lëndët “Etika në Pune” (është dhënë vetëm për semestrin e I/ Viti I), Lënda “Pune në grup” – Semestri 2/Viti I, “Menaxhimi i proceseve” – semestri I/ viti II, “TIK në shkolla & shoqeri” – Semestri I/ Viti II.

**GVJ rekomandon:**

- *Plotësimin e syllabuseve që i përkasin veprimtarisë formuese të kategorisë “C” dhe “D” dhe rishikimin e tyre. Disa prej tyre reflektojnë vitin akademik 2019/2020 ndërsa disa 2020/2021.*

GVJ konstaton vetëm në një syllabus “Programim i orientuar ne

	objekte” refletimin e organizimin të mësimit në platformen Piazza & Moodle si pasojë e situatës nga COVID -19.																															
<b>Kriteri 5.</b> Struktura dhe organizimi i programit të studimit është mjaftueshmërisht fleksibël për të mundësuar formimin e studentëve përgjatë programit dhe në përshtatje me punësimin.	Organizimi i programit mësimit bazohet në tre grup lëndë kryesore duke ofruar një fleksibilitet dhe përqëndrim të njohurive. Në vitin e parë studentët marrin njohuri në dizajn grafik dhe animacion ndërsa në vitin e dytë njohuritë thellohen në programim softuer. GVJ në takimin me studentët konstaton që programi është në përshtatje me nivelin e tyre dhe me kërkesat e tregut të punës [takim me studentët, Ev. 14_Plan Mësimit_PP TPD].																															
<b>Kriteri 6.</b> Mësimi praktik dhe i elementeve të punës konkrete u është dhënë vendi dhe pesha e duhur në strukturë, vlerësim dhe rivlerësim.	Në programin mësimit janë shprehur qartë ngarkesa në auditor dhe jashtë saj. Një peshë në totalin prej 1200 orë zënë orët e ushtrimeve/ laboratore dhe praktika profesionale në masën 60%. <i>Tabela nr.4: Orët dhe përqindja sipas organizimit të programit mësimit;</i>																															
	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nr.</th> <th></th> <th>Orë totale në auditor</th> <th>Përqindja</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>Leksione</td> <td>480 orë</td> <td>40%</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>Ushtrime</td> <td>300 orë</td> <td>25%</td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>Laborator</td> <td>180 orë</td> <td>15 %</td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>Praktike</td> <td>240 orë</td> <td>20%</td> </tr> <tr> <td></td> <td>Totali (2-4)</td> <td>720 orë</td> <td>60 %</td> </tr> <tr> <td></td> <td>Totali (1-4)</td> <td>1200 orë</td> <td></td> </tr> </tbody> </table> <p><i>Të dhënat e paraqitura më sipër janë bazuar në planin mësimit ndërsa gjejmë një mos – përputhje me të dhënat përmbledhëse shprehur në evidencën nr.59</i> [Ev. 59_Tab përmbledhese për Aneks_RVB; Ev. 14_Plan Mësimit_PP TPD]</p>				Nr.		Orë totale në auditor	Përqindja	1	Leksione	480 orë	40%	2	Ushtrime	300 orë	25%	3	Laborator	180 orë	15 %	4	Praktike	240 orë	20%		Totali (2-4)	720 orë	60 %		Totali (1-4)	1200 orë	
Nr.		Orë totale në auditor	Përqindja																													
1	Leksione	480 orë	40%																													
2	Ushtrime	300 orë	25%																													
3	Laborator	180 orë	15 %																													
4	Praktike	240 orë	20%																													
	Totali (2-4)	720 orë	60 %																													
	Totali (1-4)	1200 orë																														
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>																												
		X																														

#### Standardi II.2

**Struktura, plani mësimit dhe shpërndarja lëndore e programeve të studimit me karakter profesional, është në përputhje me objektivat formuese, rezultateve të të nxënësve sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve dhe kërkesave të tregut të punës për këto programe.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, struktura dhe shpërndarja e në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore është në përputhje me	Programi studimit profesional “Teknik në prodhime digjitale dhe software” ofrohet në gjuhën shqipe, me 120 kredite, në 2 vite akademike, 4 (katër) semestra. Kreditet janë të llogaritura sipas sistemit ECTS. Sipas rregullores së

<p>parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>programit një krediti të formimit i korrespondon 25 orë mësimore punë të studentit, përbërë nga orë mësimore për transmetim dijesh në auditor (leksione, seminare, ushtrime, laboratore, etj.) dhe orë mësimore për përgatitje ose punë individuale të tij.</p> <p>Veprimtaria akademike e këtij programi ka filluar në vitin akademik 2018-2019 dhe janë diplomuar 3 studente në vitin akademik 2019-2020. Programi nuk ka pesuar ndryshime që nga licensimi i tij nga MAS.</p> <p>Hartimi i tij dhe përmbajtja janë bazuar në kornizën ligjore, por siç u theksua edhe në standartin II.1, kriteri 2 <i>gjejmë mungesë të veprimtarive formuese të kategorisë "A" dhe "E" dhe një peshë të madhe përkatësisht të kategorisë "D" dhe jo në akordance me VKM Nr.879, datë 18.12.2019. Ev. 14_Plan Mesimor_PP TPD</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, struktura dhe shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit, rezultateve të pritshme të të nxënit dhe punësimin e studentëve.</p>	<p>GVJ gjen një përputhje me emërtimin e programit, strukturën e tij dhe objektivat dhe rezultatet e të nxënit të shprehur në syllabuset e tij</p> <p>[Ev. 14_Plan Mesimor_PP TPD; Ev. 19_Syllabuse-PP_TPD].</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Plani mësimor, natyra dhe emërtimi i moduleve/ lëndëve, syllabuset e moduleve e të aktiviteteve formuese janë informuese dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara.</p>	<p><i>GVJ rithekson mendimin e shprehur në standartin II.1 kriteri 2 dhe kriteri 4 për nevojën e rishikimit të programit mësimor dhe syllabuseve të tij.</i></p> <p>Emërtimet e lëndëve në programin mësimor janë të grupuar në tre kategori kryesore por evidentojmë mosshpërndarje të tyre sipas veprimtarive formuese të shprehur në rregulloren e programit dhe sipas kornizës ligjore të VKM nr.897 datë 1812.2019.</p> <p>Syllabuset përmbajnë të gjithë elementet e shprehur në aneksin 3 të VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 për "Elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", por nevojitet plotësimi dhe rishikimi i tyre në aspektin kohor . Ev. 19_Syllabuse-PP_TPD</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Ka një raport të balancuar midis moduleve/ aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimin në praktikë/ punë konkrete në profesion.</p>	<p>GVJ konstaton në përmbajtjen e programit profesional "Teknik në prodhime digjitale dhe software" një raport 40% teori kundrejt 60% praktikë. Në këtë program në çdo semestër është vendosur edhe "Trajnimi praktik" i vlerësuar me 6 ECTS/ semester duke zënë një peshë 20% të programit. <i>GVJ konstaton se trajnimi praktik nuk është në standartin e kërkuar dhe për këtë sugjeron edhe një rishikim të programit duke vendosur edhe rritje të peshës për këtë veprimtari formuese [Ev. 14_Plan Mesimor_PP TPD].</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Klasifikimi sipas aktiviteteve</p>	<p>Formimi teori/ praktikë, në programin e studimit ka një</p>

formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe orientimin e studentit drejt studimeve të mëtejshme dhe/ ose në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	raport të duhur në mënyrë që studentët të marrin të gjitha njohuritë teorike të ndërthurura me ato praktike dhe mundëson arritjen e transmetimit dhe përvetësimit të dijeve që tregu i punës kërkon nga studenti pas përfundimit të studimeve. Gjatë vizitës studentët u shprehën se i kishin njohuritë e nevojshme për t'u integruar në ambientin e punës, por bazuar edhe në të dhenat e shprehur me lart <b>GVJ rekomandon një rishikim të programit mesimor dhe rritje të peshës së praktikës profesionale/ intershipit [Ev. 14_Plan Mesimor_PP TPD.; takim me studentët].</b>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.3	
Përmbajtja e lëndëve, moduleve dhe formave të tjera formuese të programeve të studimit me karakter profesional është në përputhje me objektivat formuese, rezultatet e të nxëniet dhe kërkesat e tregut të punës për këto programe	
Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përmban të dhëna të plota mbi përmbajtjen e moduleve/ lëndëve të formimit teorik e praktik dhe aktiviteteve të tjera të formimit sipas strukturës e planit të studimit.	Programi i studimit profesional “Teknik në prodhime digjitale dhe software” pasqyron qarte katër modulet kryesore dhe lëndët përbërëse të secilit prej tyre. Programi nuk është përmirësuar që në vitin 2018 ku hyri për herë të parë pas marrjes së aprovimit zyrtar nga MAS. Në takimin e zhvilluar me përfaqësues të UniBa u theksua nevoja për përmirësime të tij [takimi nr.1]. Nga drejtuesit e DSHAK u theksua nevoja për ndryshim kryesisht në vendosjen e veprimtarive formuese të kategorise “A” dhe detyrimeve përmbyllëse në kategorinë “E”. Programi nuk ka pësuar ndryshime për shkak të mos akreditimit të tij deri në ditet tona [takim me Dekanin e Fakultetit, takim shefin e departamentit të DSHAK; Ev. 14_Plan Mesimor_PP TPD]
<b>Kriteri 2.</b> Përmbajtja e programit të studimit është aktuale, i plotëson kërkesat e veçanta të profesionit dhe kërkesat për aftësitë shprehite e kërkua/ të pritshme nga punëdhënësit.	Programi i studimit me karakter profesional “Teknik në prodhime digjitale dhe software” është koherent me zhvillimet teknologjike dhe me kërkesat e tregut të punës. <b>GVJ konstaton se përmbajtja e tij ka nevojë për rishikim dhe ristrukturim të tij duke ndërfutur edhe veprimtaritë formuese baze dhe përmblylles sipas kornizës ligjore në fuqi.</b>  Drejtuesit e DSHAK kanë hartuar edhe një draft program mesimor i cili pritet të miratohet dhe zbatohet menjëherë pas procesit të akreditimit për këtë program. Në këtë draft kemi një ristrukturim dhe futje të lëndëve të reja. GVJ është koherent që ky draft nuk është pjesë përbërëse e procesit të vlerësimit për këtë program por e gjen me vend të theksojë ndryshimet që DSHAK ka parashikuar të bëjë në drejtim të programit duke anashkaluar tërësisht dy modulet kryesore përkatësisht “Dizajn

	<p>Dixhital dhe Interaktiv” dhe “Dizajn Grafik dhe Animacion” dhe duke i vënë theksin në këtë draft elementeve të programimit software, database dhe programim industrial dhe rrjetat kompjuterike të cilat parashikohen të zhvillohen përgjatë vitit të parë dhe të dytë të cilat përmbushin më mirë përkufizimin e një specialisti në produkte digjitale dhe software [Ev.2 Plani mesimor profesional - draft.- dokumenta shitesë].</p> <p>Për sa i përket programit ekzistues GVJ konstaton se numri i studentëve të diplomuar është i vogël (vetëm 3 në vitin akademik 2019-2020) ku 2 prej tyre janë punësuar sipas fushës së diplomës, është relativisht i ulët për të konkluduar në lidhje me cilësinë e programit të studimit dhe plotësimin e kërkesave të pritshme nga ana e punëdhënesit. GVJ ne shqyrtimin e përmbajtjes së programit mësimor, syllabuseve konkludon se njohuritë teroike dhe praktike janë koherente dhe garantojnë cilësi në aftësimin e studentit dhe punësimin e tyre [Ev. 14_Plan Mesimor_PP_TPD. Ev. 19_Syllabuse-PP_TPD].</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Përmbajtja parashikon zhvillimin e aftësive të transferueshme, e shtrirë edhe në modulet e përmbajtjen e tyre, gjatë zhvillimit të kurrikulës dhe në metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit.</p>	<p>Referuar nenit 80, 81, 82 në Rregulloren e UniBa dhe neni 14 i Rregullosës së programit të studimit, “Kushtet per transferimet ndermjet programeve”, UniBa ofron mundësinë për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve midis programeve të të njëjtit cikël studimi brenda tij ose nga intitucione të tjera të licensuara dhe të akredituara të Arsimit të Lartë dhe anasjelltas brenda dhe jashtë vendit. Studentët që ndjekin një program mund të transferohen në një program tjetër me kërkesë të tyre pranë Sekretarisë Mësimore të Fakultetit. Transferimi nga një program në tjetrin brenda UniBa-së bëhet në fillim të çdo viti akademik, në varësi të afërsisë së programit të studimeve dhe në përputhje me rregulloren e transferimeve. Studenti që transferohet nga një IAL në UniBa krahas plotësimin të formularit duhet të paraqesë pranë sekretarisë mësimore të Fakultetit dokumentat e mëposhtme;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vërtetim ose certificate transferimit nga IAL;</li> <li>- Vërtetim nga IAL për detyrimet e shlyera në këtë shkollë, me notat/ vlerësimet përkatëse dhe kreditet e fituara;</li> <li>- Kopje të noterizuar të diplomës së shkollës së mesme;</li> <li>- Dokument identifikimi;</li> <li>- Dokumente të tjera të shprehura sipas udhëzimeve të MAS;</li> </ul> <p>Njohja e lëndëve dhe vlerësimi i krediteve, bëhet nga një komision i veçantë i ngritur për këtë qëllim. Ne takimin e bere në sekretarinë mësimore GVJ verifikoi edhe procedurën e tansferimit të studentëve dhe gjeti përputhshmëri të zbatimit të saj me dipozitat ligjore të përcaktuara në Rregullorenve UniBa dhe rregulloren e programit të studimit dhe ne akordancë me</p>

kornizën ligjore në fuqi.

*Tabela nr 5: Cilësia në hyrje dhe në dalje të studentëve*

Viti akademik	Të regjistruar për herë të parë	Nota mesatare në hyrje	Studentë të transferuar për brezat	Total
2018-2019	10	5.54	-	10
2019-2020	2	6.01	2	2
2020-2021	-	-	-	-
2021-2022	-	-	-	-
Total				12

*[Ev. 27.28\_Regjistrimet, Ecuria, Nota Mesatare; Ev. 59\_Tab përmbledhese per Aneks\_RVB]*

**Kriteri 4.** Modulet dhe aktivitetet e formimit teorik e praktik/ punë konkrete mundësojnë përftimin e njohurive, aftësive dhe shkathtësi ndërkurrikulare, të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve në kontekste konkrete, komunikimin dhe marrëdhëniet me të tjerë, si dhe orientimin cilësor në përvojën e punës.

Programi mësimor është bazuar në katër module kryesore. Në veprimtarinë formuese janë vendosur edhe lëndë me zgjedhje që konsistojnë në aftësimin e studenteve në gjuhë të huaj (anglisht dhe gjermanisht), në aftësimin e punës së tij në grup. Në këtë program mësimor raporti teori me praktikë është 40%:60% ç'ka tregon në mënyrë të qarte synimin e DSHAK drejt aftësimit praktik të studentëve. Në çdo semestër të programit mësimor organizohet "Trajnimi praktik" (6 ECTS). Përmes praktikës profesionale synohet në zhvillimin e aftësisë së studentit nga ana profesionale dhe përgatitjen cilësore të tij për të lehtësuar edhe integrimin e tij në tregun e punës. DSHAK ka hartuar edhe paketën e praktikës për programet me karakter profesional *[Ev. 56\_Paketa e praktikës së PP\_UniBa]*. Zhvillimi i praktikës profesionale në kompani pritëse (private ose institucione) krijon mundësinë studentit të përballet me situata të reja, të ndikojë në zgjidhjen e tyre, në marrjen e vendimeve dhe në aftësimin e komunikimit me grupet e punës. GVJ e konsideron pozitive këtë praktikë dhe mbështet edhe draft programin e rishikuar të hartuar nga DSHAK ku ruhet kjo përvojë dhe "Aftësimi praktik" është projektuar të zhvillohet në çdo vit akademik (secila vlerësuar me 3 ECTS) dhe në semestrin e II të vitit të dytë me 4 ECTS *[takim me stafin akademik, takim me studentët, 2.Plani mësimor profesional – draft- dokumenta shtesë; Ev. 14\_Plan Mësimor\_PP TPD]*.

**Kriteri 5.** Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/ përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në

UniBa dhe DSHAK kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me shumë kompani private dhe institucione shtetërore për zhvillimin e praktikës profesionale. Zhvillimi i praktikës

<p>profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.</p>	<p>monitorohet nga stafi akademik dhe i nënshtrohet procedurës së parashikuar në rregulloren “Paketa e praktikës për programet me karakter profesional”. Në fund të çdo semestri organizohen edhe pyetsorë që plotësohen nga studentët me qëllim përthithjen e mendimit dhe vlerësimit të tyre për praktiken. Trajnimi praktik është konsideruar si pozitive. Me 100% janë vlerësuar përmbajtja, ngarkesa e lëndës, procesi i vlerësimit, aftësimi i të menduarit kritik dhe formimi profesional. Në kufijtë 86-95% konsiderohen materialet mbështese, përmbajtja e lëndës dhe përshtatshmeria e saj me praktikën [5&amp;6 Raport dhe Pyetjet e vlerësimit të anketave të studenteve- dokumenta shtesë].</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
		<p>X</p>		

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
		<p>X</p>		

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional përmes politikave e udhëzimeve të posaçme dhe mbështetet në metodat dhe praktikat më të mira të fushës	
Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues të posaçëm, ngre struktura të posaçme dhe zhvillon mekanizma të vlerësimit e të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies dhe metodave të përdorura dhe aftësive të stafit të angazhuar, duke përfshirë aktivisht studentët në këtë proces. Rezultatet e këtyre vlerësimeve bëhen publike.</p>	<p>UniBa i kushton një vëmendje të veçantë garantimit të cilësisë së mësimdhënies. Neni 27 dhe 28 në Statut përcakton qartë rolin dhe detyrat e Komisionit të Vlerësimit të Performancës dhe Komisionit të Sigurimit të Cilësisë si dy organe kolegjiale në varesi të Rektorit të Universitetit [Ev. 2_Statuti i UniBa]. Komisioni i sigurimit të performancës vepron mbi bazën e një rregullore të aprovuar ku Kreu II i saj përshkruan qartë strukturat kompetente për procesin e vlerësimit dhe menaxhimit të performancës [Ev. 11.1_Rreg_Vlerësimin&amp;Adm. e Performacës]. Strukturat kompetente për vlerësimin e personelit në institucion dhe menaxhimin e procesit janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Departamenti i Shkencave të Aplikuara dhe Kompjuterike;</li> <li>Komisioni i Vlerësimit të Performancës (KVP);</li> <li>Zyra e Menaxhimit dhe Administrimit të Performancës;</li> <li>Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore;</li> </ol> <p>Kreu III në Rregulloren e Vlerësimit dhe Administrimit të Performancës përcakton qartë mënyrën e organizimit të procesit të vlerësimit të cilin GVJ e gjen në përputhje me zbatimin praktik bazuar në mendimet dhe opionet e mbledhura në takimet e zhvilluara [vizitat në institucion; Ev. 11.1_Rreg_Vlerësimin&amp;Adm. e Performacës- Kreu III; Ev. 8_Rreg_Njësisë së Zhv. te Kurrikul&amp;Cilesisë].</p> <p>Kriteret e vlerësimit janë të dhëna qartë në nenin 13 të kësaj rregullore. UniBa bazohet në vlerësimin e performancës dhe cilësisë së mësimdhënies në kriteret si vijon më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Mesimdhënia</li> <li>Punime kërkimore -shkencore dhe/ose aplikative;</li> <li>Angazhimit administrative;</li> <li>Disiplina;</li> </ol> <p>Dokumentat baze mbi të cilat bëhet analiza e performancës së stafit akademik dhe vlerësimit të procesit të mësimdhënies dhe cilësisë së tij janë si vijon më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Hartimi i pyetsoreve të studentëve, zhvillimi i anketimeve dhe analizimi i të dhenave nga Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë (NJZHKC), rezultatet e të cilave përcillen përmes emailit tek Zv. Rektori Akademik, Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerezore (ZMBNJ) dhe Zyra e Menaxhimit të Performancës (ZMAP); Komisioni i vlerësimit të performancës shqyrton dosjet e vlerësimit gjatë sesionit në fund të semestrit dhe konkludon me përpilimin e marrjes së vendimit të natyrës</li> </ol>



	<p>rekomanduese, propozuese ose ekzekutuese lidhur me rezultatet e vleresimit [Ev. 40_Pyetesori Standard për studentët; Ev. 37_Raport i vlerësimit të brendshëm; Ev. 40_Formular vlerësimi i studentëve për lëndën; Dok Shtesë 5&amp;6 Raport dhe Pyetjet e vlerësimit të anketave të studentëve].</p> <p>2. Personeli akademik harton një raportim të punës semestrale me kërkesë të ZBNJ dhe ZMAP [Ev. 41_Pyetesori i stafit akademik dhe ndihmës akademik];</p> <p>3. Shefi i DSHAK monitoron në mënyrë të vazhdueshme procesin mësimor, frekuentimin e tij nga studentët, monitoron stafin akademik. Ky department mbledh të dhëna në lidhje me ngarkesën mësimore, realizimin dhe problematikat e hasura të cilat përcillen në sekretarinë mësimore dhe vijon më pas tek Zv. Rektori Akademik, Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerezore (ZMBNJ) dhe Zyra e Menaxhimit të Performances (ZMAP) ndonëse GVJ konstaton një mungesë të raporteve periodike të hartuar nga DSHAK në fund të vitit akademik (2018-2021);</p> <p>4. ZMBNJ moniton dhe harton një raport në lidhje me masat disiplinore dhe prezenca (e cila është edhe kriteri “d” në vlerësimin e performancës përmendur më lart);</p> <p>GVJ konstaton një menaxhim të informacionit dhe shpërndarje të duhur të tij në të gjithë hallkat administrative, akademike dhe kolegjiale dhe bërja publike e një pjese të tij (aty ku është e nevojshme për tu paraqitur).</p>																				
<p><b>Kriteri 2.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra e kursit/ eseja, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni e që është e përshtatshme për realizimin e programit të studimit.</p>	<p>Format e mësimdhënies janë shprehur qartë në nenin 11 të rregullores së programit mesimor [Ev. 7_Rreg_PP - Prodhime Digjitale dhe Software]. Dominojnë në veprimtarinë mësimore orët teorike dhe praktike përmes leksioneve, seminareve, detyrat e kursit, projekte kursi, praktika.</p> <p>GVJ konstaton bazuar në planin mësimor të programit të studimit format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive që janë përdorur për këtë program janë si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="592 1464 1278 1760"> <thead> <tr> <th>Nr.</th> <th></th> <th>Orë totale në auditor</th> <th>Përqindja</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>Leksione</td> <td>480 orë</td> <td>40%</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>Ushtrime</td> <td>300 orë</td> <td>25%</td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>Laborator</td> <td>180 orë</td> <td>15 %</td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>Praktike</td> <td>240</td> <td>20%</td> </tr> </tbody> </table>	Nr.		Orë totale në auditor	Përqindja	1	Leksione	480 orë	40%	2	Ushtrime	300 orë	25%	3	Laborator	180 orë	15 %	4	Praktike	240	20%
Nr.		Orë totale në auditor	Përqindja																		
1	Leksione	480 orë	40%																		
2	Ushtrime	300 orë	25%																		
3	Laborator	180 orë	15 %																		
4	Praktike	240	20%																		
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik përdor forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies,</p>	<p>Personeli akademik përdor forma të ndryshme për organizimin e mësimdhënies. Këto forma janë diferencuar gjatë periudhës së pandemisë (Covid -19) [takime me stafin akademik, takim me</p>																				

në përputhje me natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.

*studentët].*

Stafi akademik theksoi praktikën, orët laboratorike si forma më kryesore e zhvillimit të mësimdhënies. Orët laboratorike zhvillohen në laboratore të cilat qëndrojnë hapur edhe mbasditë për punë individuale të studentëve [*takim me stafin akademik*]. Nga ana e tyre u theksua puna në grup, puna individuale si dy forma që përdoren gjerësisht nga ana e tyre.

GVJ shqyrtoi me vëmendje edhe 19 syllabuse të paraqitura nga institucioni dhe evidenton si vijon më poshtë:

*Tabela nr.6: Format e mësimdhënies të reflektuar në syllabuse*

Detyrë kursi	6	31.6%
Projekte kursi	-	
Presantime	13	68.4%

- *Forma më e përdorur qëndron presantimi i cili vlerësohet me 10% dhe gjendet kryesisht në lëndë me zgjedhje dhe në lëndët e detyrueshme teknike;*
- *Detyrë kursi zhvillohet shumë pak. Kryesisht ajo zhvillohet në 6 lëndë të detyrueshme dhe në shumicën e tyre ka një peshë 30%.*
- *GVJ nuk konstaton asnjë punë në grup apo projekt të përcaktuar në syllabus.*

***Bazuar për sa më sipër GVJ rekomandon përmirësimin e formave të mësimdhënies dhe vlerësimit të studenteve. Inkurajimi i detyrave të kursit dhe punës në grup e konsiderojmë të rëndësishme në lëndët e kategorise “A”, “B” dhe “C”.***

Rereferuar përberjes së stafit akademik GVJ konstaton 4 Dr., 6MSc dhe 1 MP në përberjes së njesisë baze [Ev. 23\_Të Dhëna Tabelore Personelit(Tab 1& 2)]. GVJ shqyrtoi edhe tabelën e ngarkesës mesimore të paraqitur nga Institucioni dhe syllabuset e lendeve. Nga një kontroll konstaton si vijon më poshtë:

1. Vetëm 3 MSc dhe 1 Dr nga stafi PAE i njesisë baze angazhohen në këtë program studimit [Ev. 25\_Të dhëna për ngarkesën mesimore(Tab 4)].
2. GVJ konstaton se tabela e ngarkesës mesimore nuk rakordon me stafin që është deklaruar në syllabuse. Konkretisht në tabelën e ngarkesës mesimore për këtë program studimi janë angazhuar 2 MSc dhe 1 Dr. ndërsa në syllabuse konstatohet 3 MSc dhe 1 Dr.
3. Ngarkesa mesimore nuk tejkalon kufirin ndonëse GVJ sic shprehet edhe me sipër ka gjetur mos – akordancë të të dhënave [Ev. 25\_Të dhëna për ngarkesën mesimore(Tab 4)].

	<p>GVJ konstaton se per kete program studimit stafi akademik me graden MSc ka nje ngarkese qe varion 270-342 ore ndersa stafi me graden Dr (GVJ kishte te dhenat vetem per nje 1 DR.) ne total ka 115 ore ku vetem 25 ore jepen ne kete program studimi. Theksojme qe GVJ i mungojne te dhenat ne lidhje me ngarkesen mesimore te secilit pedagog te angazhuar ne kete program studimi dhe ne programet e tjera.</p> <p>4. GVJ konstaton ne syllabuse e dorezuara qe njesia baze angazhon nje staf prej 13 veta ku vetem 6 jane PAE pjese e departamentit. GVJ nuk eshte ne gjendje te percaktoje nese pjesa tjetere ane staf PAE nga Institucioni apo PAK ndonese per vitin 2020-2021 eshte deklaruar vetem 1 PAK [Ev. 25_Të dhëna për ngarkesën mesimore(Tab 4); Ev. 19_Syllabuse-PP_TPD; Ev. 23_Te Dhena Tabelore Personelit(Tab 1&amp; 2); Ev. 24_Personeli Akademik i PP_TPD(Tab 6.1)].</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, përfshirë ato interaktive e gjithëpërfshirëse, sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në këtë program mbarat një eksperiencë në fushën përkatëse të studimit. Takimi me stafin akademik dëshmoi për motivim dhe angazhim të tyre kundrejt punës me studentët. GVJ konstaton se numri i ulët i studentëve përbën një faktor kushtëzues për stafin akademik të trajtojnë forma të larmishme të mësimdhënies [Ev. 59_Tab permbledhese per Aneks_RVB]. Për të inkurajuar punën në grup disa prej lëndëve bëhen të bashkuara me programe të tjera të ngjashme [takim me stafin akademik].</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të mbështesë stafin përmes njohjes me shembujt e praktikave të mira, të nxisë dhe të inkurajojë personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Institucion mbështet stafin akademik në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Platformat e reja të vendosura nga institucioni kanë lehtësuar punën e stafit akademik gjatë situatës së pandemisë [Ev. 39. Manual i Mesimdhënies Online; Ev. 46.2_Manuali_Google_Classroom_Pedagogu; Ev. 46.3_Manuali_Google_Classroom_Studenti].</p> <p>Marrëveshjet e bashkëpunimit që DSHAK ka me kompanitë private të biznesit dhe institucionet shtetërore përbëjnë një bazë për marrjen e shembujve më të mirë dhe ndërfutjen e tyre në përmbajtjen e programit mësimor. [Ev. 46.3_Manuali_Google_Classroom_Studenti.;Ev.2_Institucionet Bashkëpunuese-PP_TPD(Tab 5)].</p> <p>Inkurajimi që institucionit i bën stafit akademik për pjesëmarrje në projektet kërkimore shkencore tregon mbështetjen për zgjerimin e eksperiencës dhe përvojës së tyre në fushën teknologjike e cila derivon edhe në përmirësimin e përmbajtjes së kurrikulës [Ev. 43.4_Projekte te Zbatuara dhe ne Proces Grupi Barleti.]</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<b>Standardi III.2</b>	
<b>Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike të nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor teorik e praktik, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Programi mësimor “Teknik në Prodhime Digjitale dhe Software” zhvillohet në godinën e re me 6 kate dhe me një sipërfaqje të shfrytëzueshme 4,063m<sup>2</sup>. Në këtë godinë janë të vendosur 11 laboratorë, 7 zyra për stafin akademik dhe ndihmës të tij, 14 auditorë që shërbejnë për leksione dhe seminare dhe me një sipërfaqje 1,183m<sup>2</sup> në total, palester dhe salle aerobike, bibliotekë dhe ambiente mbështetëse [Ev. 42.2_Planimetria – FSHAIK; Ev. 42_Relacion për infrastrukturën].</p> <p>Në vizitën e zhvilluar në ambientet e UniBa, GVJ konfirmon se veprimtaria akademike ushtrohet në një mjedis me hapësira të mjaftueshme, cilësore dhe funksionale ku përfshihet logjistika e nevojshme për realizimin cilësor të procesit mësimor. Mjediset mësimore dhe hapësirat ndihmëse janë të pastra, të ndriçuara e të ajrosura mjaft mire. Ambientet janë të pajisura me sistemin e ngrohjes e ftohjes, me video projektorë dhe kanë bazën e nevojshme didaktike për zhvillimin normal të procesit mësimor. Hapësira dhe infrastruktura janë të përshtatshme për zhvillimin e programit të studimit [vizite ne institucion] .</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor, si dhe sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Bazuar në relacionin total të infrastrukturës për godinën e re gjejmë të vendosur 11 laboratorë. Per programin e studimit në shqyrtim 3 laboratorë janë plotësisht të teknologjisë së informacionit dhe nga këto dy janë në dispozicion të studentëve të programit profesional “Teknik në Prodhime Digjitale dhe Software”. Laboratorët janë të pajisur me të gjithë mjetet didaktike dhe softwarët e nevojshëm për të mundësuar zhvillimin praktik të mësimdhënies [Ev. 42_Relacion për infrastrukturën.pdf; takim me stafin akademik; vizite ne insititicion].</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Literatura bazë dhe ndihmëse është e përcaktuar qartë në syllabus. Në mbështetje të saj shërben edhe fondi i bibliotekës i cili pasurohet çdo vit bazuar edhe në kërkesën e paraqitur nga njësitë bazë (pjesë e të cilës është edhe DSHAK) [vizitë në bibliotekë]. Kryesisht blihen libra nga Libri Universitar, Education Centre dhe burime të tjera të cilat sigurojnë edhe gjetjen e librave bazuar në specifikimet e përcaktuara nga stafi akademik. Problematike paraqitet gjetja e librave në gjuhën shqipe për fushën e teknologjisë dhe informacionit. Libri Universitar është një nga bazat e gjetjes së literaturës teknike në gjuhën shqipe. Kopjet për secilin literaturë janë 3-4 për secilin titull [takim me stafin e</p>

	<i>bibliotekës].</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Në mbështetje të studentëve shërben edhe biblioteka digitale JSTOR. Burime të tjera disponibël për studentët janë Open Dissertation dhe DOAJ  <i>[vizitë në bibliotekë].</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Siç është pasqyruar qartë në RVB, bazuar edhe në takimet me stafin akademik dhe vizita në institucion, vizita në laboratorë dhe ambjentet që janë vënë në dispozicion për mësimdhënien, GVJ konkludon si vijon më poshtë:  a. Institucioni ka një infrastrukturë të duhur për të garantuar zhvillimn e procesit mësimor në përputhje me standartet e ëkrkuara;  b. Në funksion të programit janë 3 laboratorë me 24-30 PC dhe të pajisur edhe me videoprojektor.  c. Pjesë e infrastrukturës është edhe laborator per certifikimet Pearson (15 PC dhe video projektor);  d. Laboratorët janë të rinj dhe në përmirësim të vazhdueshëm. Në vizitën e zhvilluar konstatuam pajisje të reja të blera dhe puna për vënien në funksion të tyre;  e. Laboratorët janë të hapur në orare të cilat mundësojnë mësimdhënien dhe punën individuale të studentit mbasdite.			
<b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Google Classroom është platforma e përdorur për mësimdhënien gjatë periudhës së pandemisë. Në këtë drejtim dy manuale janë hartuar dhe vënë në dispozicion për stafin akademik dhe studentët [Ev. 46.2_Manuali_Google_Classroom_Pedagogu; Ev. 46.3_Manuali_Google_Classroom_Studenti.]. Stafi akademik e konsideron këtë platformë të përshtatshme për zhvillimin e programit mësimor dhe kontrollin e dijeve të studentëve <i>[takim me stafin akademik].</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

### Standardi III.3

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat garantojnë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit dhe rritjen e vetëdijes për përmirësimin e tyre**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/	Universiteti Barleti ka ngritur struktura të cilat monitorojnë

<p>njësi në nivel institucional që ndjekin, vlerësojnë dhe monitorojnë procesin e mësimdhënies dhe koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/ bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së saj.</p>	<p>procesin e mësimdhënies. Njësia bazë është Departamenti në të cilin është përfshirë programi studimit, në të cilin bëhet dhe shpërndarja e lëndëve në pedagogë. Strukturë tjetër është njësia e zhvillimit të kurrikulave dhe Cilësisë e cila bashkë me njësitë e tjera përgjegjëse bën kontroll të vazhdueshëm të mësimdhënies, vlerësojnë në mënyrë periodike rezultatet e veprimtarive mësimore dhe shkencore. Këto kontrole bëhen dhe me pyetësorët e vazhdueshëm për programin dhe studentët te cilat bëhen dy herë në vit dy javë para sezoni të provimeve. Bëhen analizimet përkatëse dhe me pas i dërgohen organeve drejtuese dhe propozohen ndryshime për përmirësime të nevojshme. Dokumentacion 9 paraqitur nga fakulteti janë rregullore e veprimtarive të njësisë së kurrikulave dhe Cilësisë, Pyetësorët e studentëve, dhe të dhënat e ngarkesës mësimore, rregullore e vlerësimit dhe Administrimit të performacës. Institucioni ka paraqitur dhe një rregullore për vlerësimin dhe administrimin e performancës.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Ev. 8_Rreg_Njesise se Zhv. te Kurrikul&amp;Cilesise.pdf</p> <p>Ev. 25_Të dhëna për ngarkesën mësimore(Tab 4).pdf</p> <p>Ev. 11.1_Rreg_Vlerësimin&amp;Adm. e Performacës.pdf</p> <p>Ev. 13.52_Manuali i hartimit&amp;ndryshimit të prog. ekzistuese.pdf</p> <p>Ev. 14_Plan Mesimor_PP TPD.pdf</p> <p>Ev. 30_Të dhëna tab SSBC(Tab 24).pdf</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/ bazë është përgjegjëse për procesin e mësimdhënies, cilësinë e saj dhe rritjen e vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Njësia bazë është Departamenti në të cilin është përfshirë programi studimit në të cilin bëhet dhe shpërndarja e lëndëve në pedagogë. Departamenti bën përzgjedhjen e personelit akademik që do të angazhohet në mësimdhënie. Gjithashtu bën shpërndarjen e ngarkesës mësimore në mënyrë që personeli të ketë kualifikimet dhe eksperiencën e nevojshme. Në dokumentacion janë paraqitur të dhënat për ngarkesën mësimore dhe rregulloret e departamentit përkatës. Institucioni ka paraqitur dhe një manual për ndryshimin e programit ekzistues ku janë paraqitur rregullat për të bërë ndryshime në programet ekzistuese dhe në syllabuset e lëndëve.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Ev. 6b_Rreg_Dept SHAK.pdf</p> <p>Ev. 7_Rreg_PP - Prodhime Digjitale dhe Softëare.pdf</p> <p>Ev. 25_Të dhëna për ngarkesën mësimore(Tab 4).pdf</p> <p>Ev. 14_Plan Mesimor_PP TPD.pdf</p> <p>Ev. 13.52_Manuali i hartimit&amp;ndryshimit të prog.</p>

	<p>ekzistuese.pdf</p> <p>Ev. 43_Të dhëna të plota për kualifikimin dhe kërkimin shkencor.pdf</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja, në përputhje me natyrën dhe specifikën e programeve profesionale.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në Universitet pati takim me stafin akademik dhe pati një përshtypje positive për përgatitjen e t të cilën mund ta shikojmë dhe në CV e tyre. <i>Një nga problematikat që shikojmë shqetësuese është fakti që nuk ka patur studentë për dy vite dhe konkretisht në programi e studimit nuk mund të bëjmë një vërfikim të saktë.</i> Stafi akademik ka patur trajnime të ndryshme për përmirësimin e mësimdhënies dhe për zbatimin e metodave të reja si “Gamification”. Këto trajnime janë pasqyruar dhe tek dokumentacionet e dorëzuara nga fakulteti.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Ev. 25_Të dhëna për ngarkesën mësimore(Tab 4).pdf</p> <p>Ev. 14_Plan Mesimor_PP TPD.pdf</p> <p>Ev 33_Trajnimet profesionale të mëtejshme-PP_TPD.pdf</p> <p>Ev. 14_Plan Mesimor_PP TPD.pdf</p> <p>Ev. 20.21.22_CV e Stafit Akademik.pdf</p> <p>Ev. 24_Personeli Akademik i PP_TPD(Tab 6.1).pdf</p> <p>Ev. 25_Të dhëna për ngarkesën mësimore(Tab 4).pdf</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies përmes trajnimeve të vazhdueshme të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit e tyre.</p>	<p>Institucioni Universiteti Barleti ka paraqitur në dokumentacionin e vet trajnime të cilat janë ndjekur nga stafi akademik për zhvillimin e metodave të mësimdhënies moderne. Gjithashtu stafi akademik ka patur dhe trajnim për zhvillimin e mësimdhënies online që është zbatuar gjatë pandemisë. Stafi akademik gjithashtu është përfshirë në mobilitete dhe në aktivitete ndërkombëtare. Institucioni ka paraqitur në dokumentacion të dhëna dhe për kualifikimet dhe kërkimin shkencorë.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Ev 33_Trajnimet profesionale të mëtejshme-PP_TPD.pdf</p> <p>Ev. 43.1_Lista e konferencave, work shop, Trajnimeve 2015+.pdf</p> <p>Ev. 43.4_Projekte te Zbatuara dhe ne Proces Grupi Barleti.pdf</p> <p>Ev. 43.2_Lista e Aktiviteteve Ndërkombëtare.pdf</p> <p>Ev. 43.3_Të dhëna mbi Mobilitetin.pdf</p> <p>Ev. 43_Të dhëna të plota për kualifikimin dhe kërkimin shkencor.pdf</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë</p>	<p>Insitucioni UniBa ka paraqitur që ka transparencë të dokumentuar të veprimtarive të stafik akademik të tij. Departamenti dhe Fakulteti bëjnë mbledhje dhe analiza të përvitshme. Personeli akademik mund të diskutojnë për</p>

periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	metoda të ndryshme të mësimit, efektshmëri të tyre. Këto diskutime mund të bëhen gjatë vitit akademik dhe në fund të çdo semestri dhe janë paraqitur dhe në dokumentacion si Analiza e PP_TPD.			
	<i>Evidenca:</i> Ev. 24_Personeli Akademik i PP_TPD(Tab 6.1).pdf Ev. 25_Të dhëna për ngarkesën mësimore(Tab 4).pdf Ev. 38_Analize e PP_TPD.pdf			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi III.4</b>	
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme për vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësi profesionale dhe garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën për çdo student.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësi profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, të cilat bëhen publike. Institucioni mban dhe ruan dokumentacionin e vlerësimeve, ankimmimet dhe rishqyrtimet e vlerësimit, sipas afateve e procedurave në rregulloret përkatëse.	Institucioni ka paraqitur që ka në dokumentacionet tij paraqitjen e rregulloreve me të cilat bëhen dhe testimet e stafit akademik. Në rregulloren e UniBa neni 21 përcakton që vlerësimet janë të paraqitura dhe në Proçesverbalin e vlerësimit edhe në Rregjistrin e Rezultateve Akademike. Këto rezultate i bëhen të ditura studenteve në javën e parë të mësimit kur i bëhet dhe njohja e syllabusit të lëndëve. Syllabuset e lëndëve janë paraqitur në dokumentacion dhe gjithashtu për studentet janë publikuar në google classroom. Mënyra e vlerësimit është paraqitur dhe në rregulloren e programit të studimit.  <i>Evidenca:</i> Ev. 5_Rregullore e UniBa.pdf Ev. 7_Rreg_PP - Prodhime Digjitale dhe Softëare.pdf Ev. 19_Syllabuse-PP_TPD.pdf
<b>Kriteri 2.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësi profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Institucioni ka paraqitur dokumentacionin për mënyrën se si realizohet vlerësimi i njohurive të studentëve në këtë program studimi. Forma me të cilën vlerësohen studentët është vlerësimi i vazhdueshëm gjatë gjithë vitit akademik. Në rregulloren e programit të studimit Kreu III, neni 17 jepen:  a) kriteret dhe format e vlerësimit të studentit përcaktohen në planin mësimor, në programin e lëndës dhe i bëhen të njohura dhe studentit.  b) Vlerësimi në një lëndë mund të bëhet: më provim me shkrim me gojë dhe i kombinuar, me detyra kursi projekte



	<p>dhe postera, etj.</p> <p>c) Shkalla e përvetësimit të dijeve bëhet nga sistemi me notë, me pikë ose me përqindje, dhe me shkronja sistemi ETSC.</p> <p>Kalimi nga njëri sistem vlerësimi në tjetrin bëhet në përputhje me diagramën që vijon: Rregullorja akademike, rregullorja e programit dhe syllabusi i lëndëve. Studentët në çdo fillim viti akademik informohen nëpërmjet prezantimit të syllabusit të lëndës nga pedagogët përkatës për formën e vlerësimit të dijeve. Proçesverbalet e të gjitha lëndëve hidhen në sistemin e brendshëm të Universitetit dhe gjithashtu dorezohen dhe në sekretarinë e fakultetit. Këto dokumentacione u konfirmuan dhe nga vizita në institucion dhe takimi me sekretarinë e fakultetit dhe të grupeve të tjera.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Ev. 5_Rregullore e UniBa.pdf</p> <p>Ev. 7_Rreg_PP - Prodhime Digjitale dhe Software.pdf</p> <p>Ev. 19_Syllabuse-PP_TPD.pdf</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në fillim të çdo lënde/ moduli, studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës /modulit.</p>	<p>UniBa ka paraqitur dokumentacion transparent për mënyrën e informimit të studentëve të të gjitha informacioneve në lidhje me programin e studimit. Këto informacione janë publikuar dhe në faqen e web-it. Njohja e programit të studimit, lëndët që duhet të frekuentohen dhe mundësitë e punësimit jepen në prezantimin e programit të studimit. Studentët në çdo fillim viti akademik informohen nëpërmjet prezantimit të syllabusit të lëndës nga pedagogët përkatës për formën e vlerësimit të dijeve.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Ev. 5_Rregullore e UniBa.pdf</p> <p>Ev. 7_Rreg_PP - Prodhime Digjitale dhe Softëare.pdf</p> <p>Ev. 19_Syllabuse-PP_TPD.pdf</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik, duke venë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat garantojnë anonimatën, eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Universiteti Barleti ka paraqitur dokumentacionin për mënyrën se si realizohet vlerësimi i njohurive të studentëve në këtë program studimi. Forma me të cilën vlerësohen studentët është vlerësimi i vazhdueshëm gjatë gjithë vitit akademik. Pra testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik. Testimi realizohet nëpërmjet provimeve, kuizeve, detyrave të shëpisë etj. Gjatë periudhës së pandemisë që mësimi është bërë online dhe testimi dhe shumica e komunikimeve janë bërë elektronike. Institucioni ka paraqitur që aktualisht janë duke përdorur google classroom për komunikimin elektronik me studentët.</p>

	<p><i>Evidenca:</i></p> <p>Ev. 5_Rregullore e UniBa.pdf</p> <p>Ev. 7_Rreg_PP - Prodhime Digjitale dhe Softëare.pdf</p> <p>Ev. 46.1_Plani Udhezues TIK.pdf</p> <p>Ev. 46.2_Manuali_Google_Classroom_Pedagogu.pdf</p> <p>Ev. 46.3_Manuali_Google_Classroom_Studenti.pdf</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisione provimi, shoqërohet me komente e këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>UniBa ka paraqitur se vlerësimi i njohurive dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimit. Sipas nivelit 5 të kornizës Shqipëtare të kualifikimeve detyrimet e studentit për diplomim konsiderohen të përfunduara pas përmbysjes së detyrimeve të parashikuara në planin mësimor. Institucioni i jep mundësinë studentëve që të përmirësojnë vlerësimin e marr në lende të ndryshme në vitin akademik aktual në provimet e sezonit të vjeshtës. Kjo bën të mundur që studenti të përmirësohet në të ardhmen e tij. Gjithashtu në lëndët mësimore bëhen praktika të cilat marrin një pjesë të konsiderueshme të vlerësimit të studentit. Kjo është e përcaktuar dhe në syllabuset e lëndëve. Studentit i behet një vlerësim i vazhdueshëm i njohurive, kjo i jep mundësinë pedagogëve që të japin komentet dhe sugjerimet e tyre që të përmirësohen në të ardhmen.</p> <p>Ev. 7_Rreg_PP - Prodhime Digjitale dhe Software.pdf</p> <p>Ev. 19_Syllabuse-PP_TPD.pdf</p> <p>Ev. 9_Rreg_per Funx. e Sekretarise Mesimore.pdf(Neni 6, 7, 8)</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse, duke garantuar njëkohësisht të drejtat e studentëve, për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me këto rregullore.</p>	<p>Insitucioni vlerësimin e studenteve e ka paraqitur si një vlerësim të vazhdueshëm. Rregulloret e cituara përcaktojnë që rezultati i dijeve përcaktohen nga pikët që studentët marrin gjatë gjithë vitit nga detyrat, projekte, praktika e lëndëve, laboratorë, pikët e provimit përfundimtar etj. Duke marr parasysh që vlerësimi bëhet gjatë gjithë simestrit për secilën nga lëndët atëherë mund të vlerësohet që ky vlerësim bazohet në meritë. Këto forma të vlerësimit i paraqiten nga pedagogët përkatës në prezantimin e syllabusit të lëndës. Neni 21 i rregullores përcakton afatin 5 ditor për shpalljen e rezultateve dhe 24 orë për rishikimin të vlerësimit.</p> <p>Ev. 5_Rregullore e UniBa.pdf</p> <p>Ev. 7_Rreg_PP - Prodhime Digjitale dhe Softëare.pdf</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>

				X
--	--	--	--	---

<b>Standardi III.5</b>	
<b>Zhvillimi i programit të studimit, deri në diplomim, garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët duke dhënë njëkohësisht njohuri të aplikuara dhe kompetenca profesionale lehtësisht të përdorshme në tregun e punës, apo për studime të mëtejshme.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë përfitim e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve, që janë në përputhje me rezultatet e pritura të të nxënit për programet me karakter profesional.</p>	<p>UniBa ka paraqitur dokumentacionin e nevojshëm që të vërtetojë të gjitha përfitimet e zhvillimit të programit Profesional Teknik në Prodhime Digjitale dhe Software. Në nenin 15 të rregullores së Departamentit SHAK përcaktohet që këto programe profesionale realizohen për të dhënë njohuri të konsoliduara profesionale dhe aftësi praktike. Gjithashtu në dokumentacionin e paraqitur është dhe studimi tregut i bërë nga insitucioni për këtë program studimi. Studentët sipas programit të studimit marrin të dhënat profesionale që u duhen në punë specifike të cilat i kanë të paraqitura bashkë me prezantimin e programit të studimit. Disa nga të dhënat për përfitim e njohurive janë paraqitur dhe në tabelën e punësimit të studentëve të këtij programi studimi.</p> <p>Ev. 6b_Rreg_Dept SHAK.pdf  Ev. 5_Rregullore e UniBa.pdf  Ev. 16_Studim Tregu, PP_TPD.pdf  Ev. 17.29_Diplomimi&amp;punësimi i studentëve PP_TPD (Tab 23).pdf</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton njohuritë e përshtatshme dhe zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit, duke mbështetur diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave apo çështjeve të caktuara.</p>	<p>Lëndët e zhvilluara në këtë program studimi janë të përshtatshme për të marr zhvillim të veçantë të studentëve në fusha specifike të teknologjisë së informacionit. Kryesisht i jepet përparësi zhvillimit praktik të këtyre lëndëve. Natyra e lëndëve që zhvillohen dhe përmbajtja e programit jep njohuri në fushën e teknologjisë së Informacionit. Aftësitë e komunikimit, ndërveprimit, humane dhe sociale janë arritur nëpërmjet eventeve të ndryshme ku studentet kane marrë pjesë te cilat jane paraqitur dhe në dokumentacionet e dosjes se vetevleresimit.</p> <p>Ev. 17.29_Diplomimi&amp;punësimi i studentëve PP_TPD (Tab 23).pdf  Ev. 34_Marreveshje Bashkepunimi per Praktiken Profesionale.pdf  Ev. 43.1_Lista e konferencave, Eork shop, Trajnimeve 2015 +.pdf  Ev. 43.2_Lista e Aktiviteteve Ndërkombëtare.pdf  Ev. 56_Paketa e praktikës se PP_UniBa.pdf</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Mësimdhënia realizohet mbi</p>	<p>Insitucioni ka paraqitur që praktikat janë shumë të</p>

<p>bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikatat profesionale, duke garantuar realizimin në praktikë të marrëveshjeve me punëdhënësit e aktorët e biznesit në përfitim të formimit praktik të studentëve. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar formimin cilësor dhe për të nxitur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>rëndësishme në këtë program studimit. UniBa ka disa marrëveshje bashkëpunimi me kompani të ndryshme për praktikatat profesionale të studenteve të vet. Në ambientet e UniBa janë dy laboratorë të teknologjisë së Informacionit në përdorim të këtij programi studimi të kompletuar me softwaret dhe të gjitha mundësitë për të zhvilluar praktikatat e lëndëve.</p> <p>Ev. 34_Marreveshje Bashkepunimi per Praktiken Profesionale.pdf</p> <p>Ev. 56_Paketa e praktikes se PP_UniBa.pdf</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo moduli apo lënde, personeli akademik vlerëson, analizon e shqyrton kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, duke nxjerrë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Vlerësimi i studentëve bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe stafi akademik ka mundësinë që të shqyrtojë kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti. Këto të dhëna janë paraqitur në programin e studimit dhe në syllabuset e lëndëve. Të gjitha lëndët kanë një vlerësim maksimal për pjesën e praktikës e cila i jep mundësi studentëve që të implementojnë të gjitha njohuritë e marra nga programi i studimit. Në përfundim të programit të studimit pedagogu dorëzon dosjen e lëndës me të dhënat kryesore të lëndës si rezultati vlerësimit, syllabusi i lëndës, materialet didaktike të përdorura etj. Vlerësimi i studentëve është i paraqitur dhe në rregulloren e sekretarisë mesimorë.</p> <p>Ev. 53_Dosja e Lendes.pdf</p> <p>Ev. 19_Syllabuse-PP_TPD.pdf</p> <p>Ev. 9_Rreg_per Funx. e Sekretarise Mesimore.pdf(Neni 6, 7, 8)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni harton procedura të posaçme, të njohura e publike për diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e diplomimit. Ai mban regjistra zyrtarë të studentëve të diplomuar dhe i përditëson ata në fund të çdo viti akademik.</p>	<p>Institucioni ka paraqitur procedurat e diplomimit të studentëve të vet në këtë program studimi në dy rregullore. Në rregulloren e Akademike të Universitetit Barleti në nenet 63-70 janë paraqitur procedurat e diplomimit. Rregullorja e programit procedurat e diplomimit i ka paraqitur në nenet 22-23. Studentët që të diplomohen duhet të kenë përfunduar të gjitha detyrimet e lëndëve dhe të praktikës profesionale.</p> <p>Ev. 5_Rregullore e UniBa.pdf</p> <p>Ev. 7_Rreg_PP - Prodhime Digjitalë dhe Softëare.pdf</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësia përgjegjëse, personeli akademik dhe udhëheqësit akademikë orientojnë dhe ndihmojnë studentët për përgatitjen e punimit të diplomës, realizimin e veprimtarisë praktike dhe përpunimit të rezultateve, duke garantuar bashkëpunimin edhe me aktorë të jashtëm për realizimin e saj.</p>	<p>Institucioni Universiteti Barleti për procedurat e diplomimit të studenteve në këtë program profesional i referohet Nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të kualifikimeve. Studentët që të diplomohen duhet të kenë përfunduar të gjitha detyrimet e lëndëve dhe të praktikës profesionale. Pra duhet të kenë përfunduar të gjitha detyrimet e planit mesimor përkatës. Rregullorja e programit procedurat e diplomimit i ka paraqitur në nenet 22-23.</p>

	<p>Institucioni UniBa nuk ka paraqitur një praktikë përfundimtare të diplomimit të studentëve. Studentët konsiderohen të diplomuar pas mbylljes së provimeve dhe praktikës profesionale.</p> <p>Ev. 7_Rreg_PP - Prodhime Digjitale dhe Software.pdf</p> <p>2 Plani mesimor profesional - draft.pdf</p>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
			X	

**IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE**

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për përzgjedhjen dhe cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efikente dhe efektive nga ana e tyre</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura dhe kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura, që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të tij.</p>	<p>Universiteti Barleti ka hartuar procedura dhe kriteret të përgjithshme që garantojnë përzgjedhjen e personelit akademik të këtij programi studimi. Këto procedura të rekrutimit zakonisht zbatohen nga zyra e burimeve njerëzore. Ambientet e zyrës dhe dokumentacioni u kontrolluan gjatë vizitës në Universitet. Kualifikimi i stafit akademik është në përputhje me drejtimin dhe strukturën që ka ky program studimi. Zyra e burimeve njerëzore ndjek te gjitha procedurat nga rekturimi i stafit akademik dhe administrativë dhe vazhdimësinë e punës në institucion. Në dokumentacion janë paraqitur dhe CV e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi.</p> <p>Ev. 11_Manuali i Menaxhimit te HR.pdf Ev. 20.21.22__CV e Stafit Akademik.pdf Ev. 44_Formati i Dosjes Personale te Stafit.pdf</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program, personin përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, përfshirë tutorët apo vëzhguesit e praktikës në institucionet partnere, si dhe atë të personelit ndihmësmësimit-shkencor dhe administrativ të angazhuar.</p>	<p>Universiteti Barleti ka paraqitur në dokumentacionet e veta që disponon çdo vit të dhëna për personelin akademik të përfshirë në programin e studimit. Përfshihet dosja e personelit akademik që ndodhen në zyrën e burimeve njerëzore dhe gjithashtu dhe të dhënat e kërkimit shkencor për secilin prej anëtarëve të stafit akademik. Gjatë vizitës në institucion u panë dosjet e personelit dhe të dhënat stafit akademik. Gjithashtu prezantimi i stafit akademik të programit u bë dhe gjatë takimit në institucion. Universiteti Barleti ka paraqitur në dokumentacionet e programit të studimit dhe rregulloren e vlerësimit të stafit akademik, ngarkesën e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi (Kjo përfshin vitin akademik të fundit 2020-2021 pasi ky program studimi për dy vite nuk ka qënë I hapur).</p> <p>Ev. 11_Manuali i Menaxhimit te HR.pdf Ev. 11.1_Rreg_Vlerësimin&amp;Adm. e Performacës.pdf Ev. 25_Të dhëna për ngarkesën mësimore(Tab 4).pdf Ev. 44_Formati i Dosjes Personale te Stafit.pdf</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit me karakter profesional dhe për</p>	<p>Universiteti Barleti ka krijuar një mjedis shumë pozitivë dhe me mundësi shumë të barabarta zhvillimi për kryerjen e detyrave të stafit akademik dhe zhvillimin e mëtejshëm të tyre. Në programin e studimit ka një angazhim optimal të burimeve njerëzore te cilet mund te kryejne nje mesimdhënie shume profesionale me të</p>

<p>krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>dhënat dhe mjedise që kanë në dispozicion.</p> <p>Ev. 25_ Të dhëna për ngarkesën mësimore (Tab 4).pdf</p> <p>Ev 41. Formulari i stafit Akademik dhe ndihmës akademik.pdf</p> <p>Ev. 42.2_Planimetria - FSHAIK.pdf</p> <p>Ev. 42_Relacion për infrastrukturën.pdf</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit, përmes organizimit të programeve specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, si dhe mbështetjen për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Institucioni Universiteti Barleti ka paraqitur që mbështet stafin akademik për kualifikimin e vazhdueshëm të tyre. Në dokumentacionet e tij ka paraqitura një listë të workshop-eve, trajnimeve dhe konferencave për stafin e vet akademik. Për shembull një nga këto është Gamification in education i zhvilluar në 14.01.2020, i cili është një trajnim për të përfshirë lojërat në procesin e mësimdhënies. Gjithashtu është paraqitur një listë me aktivitete ndërkombëtare që janë zhvilluar ndër vite, lista e mobiliteteve të stafit akademik dhe një tabelë përmbledhëse për të dhënat e plota për kualifikimin dhe kërkimin shkencor.</p> <p>Ev. 43.1_Lista e konferencave, Eork shop, Trajnimeve 2015+.pdf</p> <p>Ev. 43.4_Projekte te Zbatuara dhe ne Proces Grupi Barleti.pdf</p> <p>Ev. 43.2_Lista e Aktiviteteve Ndërkombëtare.pdf</p> <p>Ev. 43.3_Të dhëna mbi Mobilitetin.pdf</p> <p>Ev. 43_Të dhëna të plota për kualifikimin dhe kërkimin shkencor.pdf</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi IV.2</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të përshtatshëm sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit me karakter profesional</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Universiteti Barleti ka hapësirë optimale për zhvillimin e mësimdhënies. UniBa nga të dhënat e paraqitura në dokumentacion disponon dy kampuse të vetat në përbërje 3 godina. Kambusi 1 ndodhet në rrugën e kosovarëve dhe ka një sipërfaqe totale 3805 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe të shfrytëzueshme 2347 m<sup>2</sup>. Kampusi 2 ndodhet në rrugën Frank Bardhi, ka një sipërfaqe totale 2933 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe të shfrytëzueshme 6415m<sup>2</sup>. Hapësirat janë të ndara në klasa leksioni, seminari, laboratorë, zyra për stafin, biblioteka, mjedise sportive dhe mbështetëse.</p> <p>Ev. 42_Relacion për infrastrukturën.pdf</p> <p>Ev. 42.2_Planimetria - FSHAIK.pdf</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore, si: klasat, laboratorët, studiot e mjediset e</p>	<p>Universiteti Barleti ka paraqitur në planimetrinë e tij një hapësirë shumë të përshtatshme me kapacitete infrastrukturore sipas</p>

<p>tjera janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies- mësimnxënies.</p>	<p>parametrave bashkëkohorë për zhvillimin e mësimdhënies. Institucioni ka mbështetur procesin e dixhitalizimit në të gjitha mjediset e veta të cilat janë në dispozicion të stafit akademik dhe të studentëve. Gjithashtu dhe të studentëve që do të jenë pjesë e këtij programi studimi. Mjediset mësimore janë të pajisura me të gjitha pajisjet elektronike dhe të teknologjisë së informacionit. Kampusi ka në të gjitha mjediset e veta rrjetet wifi, pajisjet elektronike si PC, laptop, printera, skaner etj këto dhe në zyrat e stafit akademik. Gjatë vizitës në institucion u vëzhguan të gjitha mjediset e mësimdhënies dhe gjithçka e paraqitur në dokumentacione për zhvillimin digjital ishte e zbatuar pothuaj në të gjitha ambientet e kampusit.</p> <p>Ev. 42_Relacion për infrastrukturën.pdf Ev. 42.2_Planimetria - FSHAIK.pdf</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas fushës specifike të programit profesional, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Institucioni UniBa në kampusin e dytë që ndodhet në rrugën Frang Bardhi në të cilën është zhvilluar dhe procesi i mësimdhënies për këtë programin e studimit përbëhet nga 2 godina dhe mjediset sportive. Godina 1 ka në përbërje 7 klasa leksionesh, 16 zyra për stafin akademik, 10 laboratorë, palester, biblioteke dhe ambientet e tjera mbështetëse. Kurse Godina 2 ka 11 laboratore, 7 zyra për stafin akademik, 14 auditore, biblioteke, palestër, sallë aerobi dhe ambiente të tjera mbështetëse. Institucioni ka infrastrukturë të përshtatshme teknologjike për lëndët e programit të studimit. Në laboratore janë të instaluar të gjitha sistemet operative të nevojshme, software-ët e nevojshëm si Adobe Photoshop, Adobe Dreamwaver, XAMPP etj.</p> <p>Ev. 42_Relacion për infrastrukturën.pdf Ev. 46.1_Plani Udhezues TIK.pdf Udhezues TIK.pdf</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>Institucioni në kampusin e dytë ku është zhvilluar ky program studimi zotëron 10 laboratorë në godinën e parë dhe 11 laboratorë në godinën e dytë. Aktualisht UniBaka paraqitur që 3 laboratorë janë plotësisht të teknologjisë së informacionit dhe nga këto dy janë në dispozicion të studentëve të programit profesional “Teknik në Prodhime Digjitalë dhe Software”. Këto laboratorë janë të pajisur plotësisht me të gjitha mundësitë praktike në këto fusha. Gjithashtu dhe mjediset e tjera për programin e studimit, sallat e leksionit, seminarit, studio përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, praktikave dhe objektivave formuese të tij në tërësi.</p> <p>Ev. 42_Relacion për infrastrukturën.pdf Ev. 46.1_Plani Udhezues TIK.pdf Udhezues TIK.pdf</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me</p>	<p>Institucioni UniBa ka paraqitur në dokumentacionet e veta dhe</p>



<p>kapacitetet që zotëron dhe/ ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale, internship-it dhe veprimtarive të tjera praktike thelbësore për programet me karakter profesional.</p>	<p>nga vizita direkte në mjediset e veta të GVJ se i zotëron të gjitha kapacitetet infrastrukture të nevojshme për zhvillimin e këtij programi studimi dhe të praktikave të tij profesionale. Në dokumentacion është paraqitur dhe një listë me institucionet bashkëpunuese për të plotësuar të gjitha nevojat për praktika profesionale dhe për internship-e për programet profesionale që ai ofron. Institucioni UniBa ka paraqitur që ka dhe direkte marrvëshje bashkëpunimi për praktikat profesionale.</p> <p>Gjithashtu një pjesë e mirë e praktikave mësimore është e mundur që të kryhet në laboratorët e teknologjisë së informacionit.</p> <p>Institucioni ka kryer dhe një raport periodik analitik për Marrëveshjet e Bashkëpunimit.</p> <p>Ev. 42_Relacion për infrastrukturën.pdf</p> <p>Ev. 46.1_Plani Udhezues TIK.pdf</p> <p>Ev. 32_Institucionet Bashkëpunuese-PP_TPD(Tab 5).pdf</p> <p>Ev. 34_Marreveshje Bashkepunimi per Praktiken Profesionale.pdf</p> <p>Ev. 35_Raporti Periodik Analitik per Marreveshje Bashkepunimi.pdf</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p><b>Standardi IV.3</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse e të posaçme të mësimnxënies, bibliotekën e literaturën dhe mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe realizimin cilësor të tij</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p> <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit dhe krijon kushte për akses të barabartë e pa pagesë dhe të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p><b>Vlerësimi</b></p> <p>UniBa ka vendosur në dispozicion të studenteve të tij dhe të këtij programi studimi disa salla bibliotekash. Biblioteka është vendosur në hapësira të ndryshme të univesitetit me qëllim lehtësinë e aksesimit të tyre. Biblioteka është e ndarë në dy kampuse. Në kampusin 2 njësia qendrore e bibliotekës ndodhet në katin e 1-rë me një hapësirë 27.3 m2 dhe me 18 poste leximi. Kjo shërben gjithashtu për arkivimin e një kopje të cdo libri fizik që ka biblioteka, arkivimit të dokumentacionit të bibliotekës, arkivimin e punimeve të diplomave të studentëve si dhe vend-adresimin e stafit apo studentëve për cdo nevojë apo problematike që lidhet me bibliotekën. Nga kjo njësi bazë biblioteka zgjerohet po Brenda Kampusit 2 me një tjetër hapësirë prej 95.1 m2 ku janë të arkivuara revisat shkencore, punimet e konferencave, periodiket e fushave të ndryshme dhe 50 poste leximi dhe poste me kompjutera për ofrimin dhe aksesimin e</p>

	<p>bibliotekes dixhitale të univestitetit dhe te bibliotekave online ndërkombëtare. Gjithashtu në katin përdhes biblioteka zgjerohet me 70 m2 dhe me 28 poste leximi dheme poste ne kompjutera për aksesimin e bibliotekave dixhitale.</p> <p>Në kampusin 1, në godinen A biblioteka ka njësinë e saj me një hapësirë 40 m2 dhe me 18 poste leximi.</p> <p>Menaxhimi i librave bëhet nëpërmjet sistemit të platformës online, i cili mundëson menaxhimin e librave të kategorive të ndryshme.</p> <p>Institucioni ka aksesuar mundësinë e e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit dhe krijon kushte dhe akses të barabartë dhe pa pagesë.</p> <p>Ev. 42.1_Relacion për infrastrukturën e bibliotekës.pdf</p> <p>Ev. 46.9_Manuali_Biblioteka_Online.pdf</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë mësimore bazë, ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka e UniBa ka një numër total të titujve në bibliotekë 5250 tituj. Njësia qendrore e saj që ndodhet në kampusin 2 shërben dhe për arkivimin e një kopje të librit fizik që ka biblioteka, arkivimi i dokumentacionit të bibliotekës, arkivimi I punimeve të diplomave të studentëve si dhe adresimin e nevojave të stafit dhe studenteve për problematikat që lidhen me bibliotekën. Institucioni gjithashtu siguron qasje dhe në bibliotekën dixhitale JSTOR e cila mundëson më shumë se 12 milion artikuj të revistave akademike, libra dhe burime kryesore ne 75 disiplina. Institucioni UniBa ka abonim me llogarinë e bibliotekes, nëpërmjet te cilës mund të aksesojnë stafi akademik dhe studentët dhe ëshë i mundur leximi online dhe ruajtja e material që kërkojnë direkt nga platforma e tyre.</p> <p>Gjithashtu institucioni ka ofruar akses për studentët dhe për stafin akademik dhe në Open Dissertations (bashkëpunim midis EBSCO dhe Bibliolabs në të cilën janë përfshirë të dhëna të disertacioneve), Spriger Link (qe siguron qasje në dokumente shkencore nga revista, libra seri, protokolle, punime referuese etj.), DOAJ (Direcroty of Oper Access Journals qe permban mbi 16500 revista ne te gjitha fushat e shkencës).</p> <p>Ev. 42.1_Relacion për infrastrukturën e bibliotekës.pdf</p> <p>Ev. 46.9_Manuali_Biblioteka_Online.pdf</p> <p>Ev. 45_Lista e teksteve periodikëve në Bibliotekë.pdf</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit dhe duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit</p>	<p>Institucioni UniBa I ka krijuar kushte studentëve për aksesimin e disa bibliotekave online. Institucioni gjithashtu siguron qasje dhe në bibliotekën dixhitale JSTOR e cila mundëson më shumë se 12 milion artikuj të revistave akademike, libra dhe burime kryesore ne 75 disiplina. Gjithashtu institucioni ka ofruar akses per studentët dhe për stafin akademik dhe në Open Dissertations (bashkëpunim midis EBSCO dhe Bibliolabs në të cilën janë</p>

<p>ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>përfshirë të dhëna të disertacioneve), Spriger Link (qe siguron qasje në dokumente shkencore nga revista, libra seri, protokolle, punime referuese etj.), DOAJ (Direcroty of Oper Access Journals qe permban mbi 16500 revista ne te gjitha fushat e shkencës).</p> <p>Aksesimi I stafit akademik dhe i studenteve ne biblioteka eshte pa pagese. Pasurimi i fondit të bibliotekës është dhe pjesë e politikave të insitucionit. Në fillim të çdo viti akademik departamenti harton listën e publikimeve me të cilat duhet pasuruar biblioteka e univestitetit. Aktualisht biblioteka e UniBa ka një numër total të titujeve në bibliotekë 5250 tituj.</p> <p>Ev. 42.1_Relacion për infrastrukturën e bibliotekës.pdf</p> <p>Ev. 46.9_Manuali_Biblioteka_Online.pdf</p> <p>Ev. 45_Lista e teksteve periodikëve në Bibliotekë.pdf</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, përmes bashkëpunimit me aktorë të jashtëm, të angazhuar në realizimin e programit mësimor, duhet t'u lehtësojnë dhe garantojë studentëve mbështetjen dhe përdorimin e burimeve e logjistikës së nevojshme të institucioneve partnere, në varësi të natyrës së angazhimit të tyre në procesin formues teorik, praktik dhe profesional të studentëve.</p>	<p>Institucioni UniBa me dokumentacionet që ka dorëzuar tregon që e disponon plotësisht infrastrukturën e përshtatshme për zhvillimin e praktikave profesionale të programit të studimit dhe gjithashtu dhe veprimtarive praktike të tjera. Pjesa kryesore e praktikave mësimore të lëndëve është e mundur që të kryhet në laboratorët e teknologjisë së informacionit.</p> <p>UniBa në dokumentacion ka paraqitur dhe një listë me institucionet bashkëpunuese për të plotësuar të gjitha nevojat për praktika profesionale dhe për internship-e për programet profesionale që ai ofron. Institucioni UniBa ka paraqitur që ka dhe direkte marrvëshje bashkëpunimi me institucione të tjera për zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve për praktikat profesionale.</p> <p>Institucioni ka kryer dhe një raport periodik analitik për Marrëveshjet e Bashkëpunimit.</p> <p>Ev. 42_Relacion për infrastrukturën.pdf</p> <p>Ev. 46.1_Plani Udhezues TIK.pdf</p> <p>Ev. 32_Institucionet Bashkëpunuese-PP_TPD(Tab 5).pdf</p> <p>Ev. 34_Marreveshje Bashkepunimi per Praktiken Profesionale.pdf</p> <p>Ev. 35_Raporti Periodik Analitik per Marreveshje Bashkepunimi.pdf</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni parashikon koston financiare të programit të studimit profesional, mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi dhe raportin financiar të përvitshëm dhe në mbyllje të çdo cikli të plotë</p>	<p>Insitucioni ka paraqitur dokumentacione me të dhënat financiare të vetat. Aktualisht këtë vitin e fundit në programin e studimit nuk ka patur studente dhe normalisht të ardhurat nga tarifa e programit për këtë vit nuk ka. Zyra e financës harton çdo vit raportet me të dhëna të hollësishme të kostove për programin e studimit për periudhën në të cilën është paraqitur. Në dokumentacion janë paraqitur të dhënat nga plani financimit të programit të studimit. Institucioni ka mundësinë për mbështetje financiare të mjaftueshme të paraqitur dhe në dokumentacionet e</p>

studimi.	<p>tyre. Këto janë paraqitur në Burimet Financiare të UniBa dhe në të dhënat nga raporti financiar vjetor intitucional.</p> <p>Ev. 50.1_Burimet Financiare UniBa.pdf</p> <p>Ev. 50_Të dhëna nga Plani i Financimit të Programit të Studimit.pdf</p> <p>Ev. 49_Të dhëna nga Raporti Financiar Vjetor Institucional.pdf</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Financimi i një programi studimi profesional duhet të sigurojë e të garantojë mbulimin e të gjitha burimeve dhe veprimtarive të qëndrueshme dhe operative, të lidhura e që janë në funksion të realizimit të programit të studimit, duke garantuar njëkohësisht qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit e në vijim.</p>	<p>Institucioni ka paraqitur një plan financimi dhe raportin financiar vjetor me të dhëna të plota dhe të pasura për financimin e burimeve njerëzore, shpenzimeve operative, detyrimet financiare, grantet etj. Raporti financiar vjetor paraqet të dhëna mbi strategjinë, misionin dhe objektivat, aspektet ekonomike, kurrikulumin, buxhetin në vite dhe kontrollin financiar.</p> <p>Auditimi i jashtëm financiar i Institucioni të Arsimit të lartë UniBa nga viti 2017 dhe në vazhdim bëhet nga kompania Grant Thornton Albania. Raportet e auditimit janë të depozituar në faqen e qendrës kombëtare të biznesit.</p> <p>Ndërsa për auditimin e brendshëm të insitucionit është krijuar Njësia e Auditimit të Brendshëm e cila nxjerr raportet e veta financiare që ia dergon menaxhimit të universitetit.</p> <p>Insitucioni i garanton të gjitha burimet financiare që duhen për programin e studimit dhe garanton qëndrueshmëri përgjatë kohës së zhvillimit të këtij programi studimit.</p> <p>Ev. 50.1_Burimet Financiare UniBa.pdf</p> <p>Ev. 50_Të dhëna nga Plani i Financimit të Programit të Studimit.pdf</p> <p>Ev. 49_Të dhëna nga Raporti Financiar Vjetor Institucional.pdf</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p><b>Standardi IV.4</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek, zbaton politika e procedura institucionale dhe i jep formacion të plotë e të hollësishëm studentëve mbi programin e studimit me karakter profesional, pranimin, përzgjedhjen, përparimin akademik, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p> <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton, zbaton dhe bën publike politika, procedura e kriteret të qarta e të kuptueshme për pranimit e studentëve, përparimin e tyre përgjatë kursit të studimit, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët</p>	<p><b>Vlerësimi</b></p> <p>UniBa ka hartuar një rregullore të programit të studimit e cila përcakton aspektet organizative të programit të studimit profesional “Teknik në prodhime digjitale dhe Software”. Ajo është hartuar në përputhje me objektivat e programit të studimit. Rregullorja e programit të studimit është e paraqitur dhe në dokumentacionin e dorëzuar nga universiteti.</p> <p>Gjithashtu Institucioni ka të hartuara dhe rregullore të tjera të</p>

<p>për studentë dhe studentët, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>cilat janë dorëzuar me dokumentacionet që janë rregullore e UniBa, Rregullore e fakultetit SHAK dhe rregullore e departamentit SHAK në të cilin është pjesë dhe programi i studimit. Në mbarëvatje të gjithë procesit të regjistrimit të studentëve të rinj zyra e pranimit dhe regjistrimeve që ndjek dhe ka detyrë funksionale organizimin dhe drejtimi e këtyre proceseve, ka hartuar dokumentin e brendshëm: “Manual, Rekrutimi, Aplikim, Regjistrim, Transferim i studenteve.” i cili gjithashtu është pjesë e dokumentacionit dhe përshkruhen të gjithë hapat që duhet të ndjekin studentët në lidhje me ndjekjen ose transferimin e studimeve në këtë Universitet.</p> <p>Ev. 5_Rregullore e UniBa.pdf  Ev. 6a_Rreg_Fakulteti i SHAK.pdf  Ev. 6b_Rreg_Dept SHAK.pdf  Ev. 7_Rreg_PP - Prodhime Digjitale dhe Softëare.pdf  Ev. 54_Manual - Rekrutim-Aplikim-Regjistrim-Transferim.pdf</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të përgjithshme dhe/ose të veçanta për pranimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit me karakter profesional dhe udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me to.</p>	<p>Institucioni ka hartuar rregullore për programin e studimi profesional “Teknik në prodhime digjitale dhe software”. Kriteret e pranimit të studentëve janë shpallur dhe në faqen e Univesitetit, në të cilën janë publikuar dhe procedura të ndryshme për stransferimin, pranimin etj këto ndodhen tek rubrika pranimit. Në faqen e univesitetit është paraqitur dhe një broshure që përfshin në përgjithësi njohjen e universitetit dhe degeve të ndryshme duke përfshirë dhe programin e studimit.</p> <p>Në fillim të vitit akademik rektorati organizon procesin e vendosje së kriterëve e pranimit të studentëve të rinj në vitin e ardhëm akademik. Fillimisht kriteret shqyrtohen ne Departament, më pas bëhen propozimet në dekanat dhe më tej në Rektorat. Senati del me vendim të posacëm për kriteret e pranimit për secilin program studimi për cdo vit akademik.</p> <p>Ev. 7_Rreg_PP - Prodhime Digjitale dhe Software.pdf  Ev. 54_Manual - Rekrutim-Aplikim-Regjistrim-Transferim.pdf  <a href="http://cit.edu.al/en/faculty-of-engineering-academic-staff/">http://cit.edu.al/en/faculty-of-engineering-academic-staff/</a>  <a href="https://umb.edu.al/pranimet.html">https://umb.edu.al/pranimet.html</a>  <a href="https://umb.edu.al/upload/pdf/Formular-aplikimi-Program-Profesional-uniba.pdf">https://umb.edu.al/upload/pdf/Formular-aplikimi-Program-Profesional-uniba.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, zhvillimin e veprimtarive praktike e profesionale të programit dhe institucionet bashkëpunuese në këto veprimtari, vlerësimit të dijeve e</p>	<p>Institucioni ka vendosur në dispozicion informacionin e hollësishëm në lidhje me kriteret e vlerësimit të dijeve të studentëve. Në rregulloren e programit të studimit profesional “Teknik në prodhime digjitale dhe software”, në pikën 3 janë paraqitur kriteret dhe format e vlerësimit të dijeve të studentëve. Format e vlerësimit të dijeve janë paraqitur dhe në syllabuset e lëndëve të cilët paraqiten javën e parë orientuese nga pedagogët e lëndëve përkatëse. Një rol shumë të rëndësishëm për këtë</p>

aftësive të studentëve dhe diplomimit.	<p>program studimi e ka dhe sekretaria mësimore e cila i informon vazhdimisht studentët për organizimin e programit, afati e përfundimit dhe statusin e organizimit të programit. Gjithashtu marrim parasysh që këtë vit akademik në këtë program studimi nuk ka patur studente të rregjistruar.</p> <p>Ev. 7_Rreg_PP - Prodhime Digjitale dhe Softëare.pdf  Ev. 14_Plan Mesimor_PP TPD.pdf  Ev. 19_Syllabuse-PP_TPD.pdf</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimeve, mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>UniBa ka marrëveshje bashkëpunimi me kompani dhe institucione të ndryshme dhe ka siguruar praktika për këtë program studimi. Prej dy vitesh ka ngritur dhe bordet e karrierës të përbërë nga personalitete dhe profesionistë të fushes Kjo duke marrë parasysh që ka disa programe studimi profesionale. Gjithashtu ka dy poste Dekani i studenteve dhe përfaqësuesi i zyrës Alumni të cilët i ndihmojnë studentët nëpërmjet takimeve të ndryshme për qartësimin e programit të studimit dhe mënyrës se si studentët mund të orientohen me vonë në karrierë. Zyra e karrierës dhe Alumni zhvillojnë vazhdimisht aktivitete për të afuar studentët me tregun e punës.</p> <p>Ev 33_Trajnimet profesionale të mëtejshme-PP_TPD.pdf  Ev. 32_Institucionet Bashkëpunuese-PP_TPD(Tab 5).pdf  Ev. 34_Marreveshje Bashkëpunimi per Praktiken Profesionale.pdf</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen, veprimtaritë formuese dhe informacion të gjerë e të përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Institucioni UniBa ka vendosur në dispozicion të studentëve të gjithë informacionin dhe udhëzuesit e posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen, veprimtaritë formuese dhe informacion të gjerë dhe të përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, infrastrukturën dhe shërbimet. Studentët kanë informacion mbi lëndët syllabuset e lendeve përkatëse, manualët gjatë mësimit online gjithashtu janë publikuar dhe të gjitha janë paraqitur dhe me dokumentacionin e dosjes së vlerësimit të programit.</p> <p>Ev. 46.1_Plani Udhezues TIK.pdf  Ev. 46.3_Manuali_Google_Classroom_Studenti.pdf  Ev. 46.4_Manuali_GSuit.pdf  Ev. 46.5_Manuali_Intranet.pdf  Ev. 46.6_Portali_Studentor.pdf  Ev. 46.7_Manuali_Studentor_Classter.pdf  Ev. 46.9_Manuali_Biblioteka_Online.pdf</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Institucioni ka një sistem të menaxhimit të brendshëm të informacionit. Sistemi është online dhe studentet mund ta aksesojnë edhe në distancë kudo ku ndodhen. Programi i studimit, lëndët e tij të ndarë dhe në semestra janë publikuar dhe në faqen e internetit të UniBa. Këto informacioni studentët mund ti aksesojnë dhe ndërmjet sistemit të menaxhimit të brendshëm.</p>


	<a href="https://online.umb.edu.al/">https://online.umb.edu.al/</a> Ev. 46.1_Plani Udhezues TIK.pdf			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi IV.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e daljen në tregun e punës.	Institucioni UniBa disponon një sistem për menaxhimin e të dhënave të studentëve si për pjesën akademike dhe atë administrative. Gjithashtu ka paraqitur që disponon dhe sisteme të tjera të koordinuara mirë mes tyre për komunikimin me studentët si portal studentor, platforma LMS e Classroom etj. Portali studentor është një sistem që përdorin studentët që mund të informohen në kohë reale në lidhje me informacionet akademike, komunikimin me pedagogët dhe rezultatet e tyre akademike.  <i>Evidenca:</i> <a href="https://online.umb.edu.al/">https://online.umb.edu.al/</a> Ev. 46.1_Plani Udhezues TIK.pdf Ev. 46.2_Manuali_Google_Classroom_Pedagogu.pdf Ev. 46.3_Manuali_Google_Classroom_Studenti.pdf Ev. 46.5_Manuali_Intranet.pdf Ev. 46.6_Portali_Studentor.pdf
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe të partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Institucioni disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit të informacionit, dokumentacionit dhe aktivitetit të personelit akademik. Dokumentacioni i nevojshëm është i aksesueshëm në intranet. Sistemin e intranetit e kemi dhe në faqen zyrtare të institucionit të monitoruar nën domain-in e universitetit. Ai përfshin gjithashtu dhe komunikimin online me platformat e veta në dispozicion dhe komunikimet me publikun nëpërmjet site-ve zyrtare, mediave sociale etj. Sistemi i menaxhimit të studenteve menaxhon dhe të dhënat e studenteve. Komunikimi me studentët bëhet dhe nëpërmjet google classroom.  <a href="https://online.umb.edu.al/">https://online.umb.edu.al/</a> Ev. 46.1_Plani Udhezues TIK.pdf Ev. 46.6_Portali_Studentor.pdf Ev. 46.2_Manuali_Google_Classroom_Pedagogu.pdf Ev. 46.3_Manuali_Google_Classroom_Studenti.pdf
<b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë	Sistemi i menaxhimit të Universitetit Barleti siguron akses të dedikuar për personelin e vet në intranet. Aksesin e dedikuar sigurohet nëpërmjet logimit me kredencialet personale, si në

<p>personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>instranet ashtu dhe ne platformat online, në bazë të kategorisë së përdoruesit.</p> <p><a href="https://online.umb.edu.al/">https://online.umb.edu.al/</a> Ev. 46.1 _Plani Udhezues TIK.pdf</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit të institucionit ka të integruara platformë dhe module që mundësojnë komunikim interaktive dhe shkëmbim të informacionit nëpërmjet personelit dhe studenteve. Universiteti ka paraqitur që në dy vitet e fundit aktivitetin mësimor, sikurse dhe komunikimi, është transferuar gradualisht në Google Classroom ku studentët mund të gjejnë informacion edhe më të detajuar për lëndët e modulet, materialet mësimore, syllabusin e lëndëve, vlerësimet, materialet shtesë etj. Një ndër format kryesore të komunikimit është me përdorimin e adresave zyrtare të email-it.</p> <p><a href="https://online.umb.edu.al/">https://online.umb.edu.al/</a> Ev. 46.1 _Plani Udhezues TIK.pdf Ev. 46.6 _Portali _Studentor.pdf Ev. 46.2 _Manuali _Google _Classroom _Pedagogu.pdf Ev. 46.3 _Manuali _Google _Classroom _Studenti.pdf</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Institucioni UniBa paraqet që sistemi i vet i menaxhimit të studentëve vepron në mënyrë të ngjashme me google classroom për komunikimin me studentët. Në sistemin e menaxhimit mund të bëhet dhe raportimi dhe analizimi i të dhënave nga organet drejtuese të Universitetit dhe nga titullaret. Kjo gjë bëhet në nivelin akademik dhe në atë administrative.</p> <p><a href="https://online.umb.edu.al/">https://online.umb.edu.al/</a> Ev. 46.1 _Plani Udhezues TIK.pdf Ev. 46.2 _Manuali _Google _Classroom _Pedagogu.pdf Ev. 46.3 _Manuali _Google _Classroom _Studenti.pdf Ev. 46.6 _Portali _Studentor.pdf</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Institucioni Universiteti Barleti ka paraqitur që i publikon publikon online të dhënat që kanë të bëjnë me programin e studimit, ofertën akademike, strukturën dhe funksionimin e institucionit. Më poshte kemi dhe te gjitha linket që jane marrë nga faja e web-it. Gjithashtu dhe për programin e studimit Teknik në Prodhime Digjitale dhe Software.</p> <p><a href="http://cit.edu.al/en/faculty-of-engineering-academic-staff/">http://cit.edu.al/en/faculty-of-engineering-academic-staff/</a> <a href="https://umb.edu.al/pranimet.html">https://umb.edu.al/pranimet.html</a> <a href="https://umb.edu.al/upload/pdf/Formular-aplikimi-Program-Profesional-uniba.pdf">https://umb.edu.al/upload/pdf/Formular-aplikimi-Program-Profesional-uniba.pdf</a></p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përbushet</b></p>	<p><b>Përbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>



Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin, në programin e studimit dhe i vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika, procedura dhe kriteret të pranimit, përparimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit të studentëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore dhe që janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Universiteti Barleti ka paraqitur që hartuar dhe zbaton procedurë për kriteret e pranimit, të transferimit, njohjes së studimeve të cilat janë përfshirë në rregulloren e programit të studimit profesional “Teknik në Prodhime Digjitale dhe software”. Gjithashtu një pjesë e mirë e procedurave janë publikuar dhe në faqen e web-it të institucionit. Rregullorja e programit të studimit është në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 si dhe VKM nr. 41, dt. 24.01.2018 ndryshuar me VKM nr.879, ft 18.02.2019.</p> <p>Universiteti Barleti ka një strukturë të organizuar për shërbimet studentore nga hyrja në dalje që drejtohen nga Zv. Rektori për ceshtjet studentore i cili drejton punën e disa zyrave si: Zyrën e rekrutimit, Pranimit dhe Regjistrimit, Dekanin e Studentëve dhe zyrën Alumni dhe Karrierës. Mënyra e funksionimit të këtyre zyrave paraqitet dhe në rregulloren e UniBa. Kriteret e pranimit, procedurat e pranimit dhe të përzgjedhjes së studentëve janë të aksesueshme dhe janë bërë publike në faqen zyrtare të UniBa.</p> <p>Ev. 7_Rreg_PP - Prodhime Digjitale dhe Software.pdf  Ev. 5_Rregullore e UniBa.pdf  Ev. 6a_Rreg_Fakulteti i SHAK.pdf  Ev. 6b_Rreg_Dept SHAK.pdf  Ev. 57_MASR miratim per hapje PP_TPD.pdf  <a href="https://umb.edu.al/pranimet.html">https://umb.edu.al/pranimet.html</a>  <a href="https://umb.edu.al/upload/pdf/Formular-aplikimi-Program-Profesional-uniba.pdf">https://umb.edu.al/upload/pdf/Formular-aplikimi-Program-Profesional-uniba.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje dhe orientimin drejt tregut të punës, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat nga hyrja tek dalja e UniBa janë të përshkruara në rregulloren e institucionit, në rregulloren e programit, manualin e bursave etj. Ato janë të barabarta për të gjithë studentët, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për studentët e programit të studimit. Në nenin 45 jepen të dhënat e programeve me karakter profesional për kozgjatjen, kreditet dhe diplomën që merret në fund të këtyre programeve.</p> <p>Ev. 2_Statuti i UniBa.pdf  Ev. 7_Rreg_PP - Prodhime Digjitale dhe Softëare.pdf  Ev. 5_Rregullore e UniBa.pdf</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik</p>	<p>Institucioni harton në çdo vit akademik kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve. Kriteret publikohen në faqen e</p>

<p>kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve dhe, përpara fillimit të çdo viti akademik, udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Universitetit dhe gjithashtu janë të parashikuara në rregulloren e programit të studimit profesional “Teknik në Prodhime Digjitale dhe Software”. UniBa ka të publikuar dhe broshura me kriteret e pranimit të studenteve dhe informacionet bazë të programit të studimit.</p> <p>Ev. 7_Rreg_PP - Prodhime Digjitale dhe Softëare.pdf  <a href="https://umb.edu.al/pranimet.html">https://umb.edu.al/pranimet.html</a></p> <p><a href="https://umb.edu.al/upload/pdf/Formular-aplikimi-Program-Profesional-uniba.pdf">https://umb.edu.al/upload/pdf/Formular-aplikimi-Program-Profesional-uniba.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, kalimit nga një vit akademik në tjetrin, procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>UniBa ka vendosur në dispozicion informacion të plotë në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve. Në këto procedura përfshihen kalimi nga një vit akademik në tjetrin, procedura për njohjen e kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. Studentët informohen në lidhje me procedurat përmes Sekretarisë dhe Koordinatorës së Departamentit. Në javën e parë të pranimit në UniBa që është dhe javë orientimi studentët njihen me të gjithë dokumentacionin zyrtar dhe shërbimet në funksion të tyre. Institucioni dhe njësite e tij i informojnë studentët në lidhje me procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. UniBa gjithashtu pranon transferimet e studentëve nga institucionet e tjera të arsimit të lartë, vendase ose të huaja, publike dhe jopublike dhe lejon transferimin e studenteve të tij në institucione të tjera.</p> <p>Ev. 7_Rreg_PP - Prodhime Digjitale dhe Softëare.pdf  <a href="https://umb.edu.al/pranimet.html">https://umb.edu.al/pranimet.html</a></p> <p>Ev. 5_Rregullore e UniBa.pdf</p> <p>Ev. 54_Manual - Rekrutim-Aplikim-Regjistrim-Transferim.pdf</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni i informon studentet në lidhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve të aftësive të studentëve në programin e studimit dhe diplomimit në këtë program studimi. Në kreun 3 në rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar kriteret dhe format e vlerësimit të dijeve të studentëve. Janë parashikuar gjithashtu procedurat lidhur me kriteret dhe procedurat e vlerësimit, të drejtat për të hyrë në provim, zhvillimi i provimeve, komunikimi vlerësimeve dhe dokumentimi i vlerësimeve.</p> <p>Në syllabusin e lëndës që i prezantohet dhe studentit javën e parë të mësimit në çdo semester janë përcaktuar gjithashtu dhe format e vlerësimit të dijeve. Këto i jepen studenteve nga pedagogu i lëndës. Kriteret e programit të studimit janë të paraqitura qartë dhe në rregulloren e programit të studimit dhe në rregulloren akademike.</p> <p>Ev. 7_Rreg_PP - Prodhime Digjitale dhe Softëare.pdf  <a href="https://umb.edu.al/pranimet.html">https://umb.edu.al/pranimet.html</a></p> <p>Ev. 5_Rregullore e UniBa.pdf</p> <p>Ev. 19_Syllabuse-PP_TPD.pdf</p>

<p><b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Institucioni ka publikuar udhëzues të posaçëm dhe ka organizuar takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm për programin e studimit. Këto janë zhvilluar në mënyrë periodike gjatë gjithë vitit akademik si politika nxitëse të rekrutimeve që janë të mbështetura në një plan vjetor. Në këto përfshihen strategji të marketingut, konferenca me maturantët, konferenca me mësuesit e karrierës nëpër gjimnaze, ekskursion turë i maturantëve nëpër ambientet e UniBa-s, vizita e stafit në gjimnaze, ku përfaqësues të departamenteve dhe pedagogë kanë prezantuar detaje nga secili program studimit. Në vitet e fundit kjo është bërë online duke marr parasysh situatën e pandemisë.</p> <p>Ev. 51_Strategjia e marketingut dhe rekrutimit.pdf</p> <p>Ev. 54_Manual - Rekrutim-Aplikim-Regjistrim-Transferim.pdf</p> <p><a href="https://umb.edu.al/pranimet.html">https://umb.edu.al/pranimet.html</a></p> <p><a href="https://umb.edu.al/upload/pdf/Formular-aplikimi-Program-Profesional-uniba.pdf">https://umb.edu.al/upload/pdf/Formular-aplikimi-Program-Profesional-uniba.pdf</a></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi V.2</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni informon në mënyrë të hollësishme studentët për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit me karakter profesional.</p>	<p>Institucioni ka paraqitur informacionin e nevojshëm për informimin e studenteve të tij për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Studentët informohen në forma të ndryshme: në mjediset e UniBa kur organizohen takimet informuese, në periudhën e regjistrimit, gjatë periudhës së studimeve kjo gjë bëhet dhe nga stafi akademik dhe administrativ. Koordinator i programit bën orientimin në lidhje me organizimin e programit të studimit. Institucioni ka vendosur në mënyrë të hollësishme infrastrukturën e mëposhtme si fletpalosje, postera, broshura të cilat janë të publikuara dhe në faqen e web-it. Studentët informacionin e nevojshëm për lëndët mund ta marrin dhe nga pedagogët përkatës pasi në fillim të çdo moduli do të zhvillohet njohja me syllabuset e lëndëve.</p> <p>Ev. 19_Syllabuse-PP_TPD.pdf</p> <p>Ev. 39. Manual i Mesimdhënieve Online.pdf</p> <p>Ev. 40.a_Guida per fokus grupin.pdf</p> <p>Ev. 40_Formular vlerësimi i studentëve për lëndën.pdf</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale</p>	<p>UniBa ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe me kompani të ndryshme për të realizuar bashkëpunime për praktika</p>

<p>në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>dhe internship për studentët dhe orientimin e tyre drejt tregut të punës. UniBa ka ngritur dhe njësi në ndihmë të orientimit të studentëve si Bordet e Karrierës të përbëra nga profesionist të fushës, Dekanin e studentëve dhe Zyra Alumni dhe e Karrierës. Këto njësi i ndihmojnë studentët drejt një punësimi të suksesshëm. Gjithashtu zyra Alumni dhe Karrieres ne bashkepunim dhe me njesite e tjera te UniBa ndihmojnë që të zhvillojnë aktivitete për të afruar studentët me tregun e punës. Nga takimi me përfaqesuesin e studentëve një pjesë e mirë e studenteve që kanë përfunduar studimet në këtë program dhe me perfaqesuesin e zyrës Alumni kishte informacion qe një pjesë e studentëve ishin të punësuar në këtë drejtimin e tyre.</p> <p>Institucioni ka dorëzuar dhe nje liste me trajnime profesionale në të cilën janë përfshirë studentët dhe stafi akademik.</p> <p>Në rregulloren e zyrës Alumni perfsihet funksioni i zyrës dhe gjithashtu dhe ndihma që duhet të japin ata në orientimin e studenteve.</p> <p>Një njohje fillestare të mundësive të punësimit në këtë program studentëve u jepet që në prezantimin e programit të studimit.</p> <p>Informacion i detajuar për programin e studimit dhe mundësive të punësimit është dhënë dhe në studimin e tregut të punës që është paraqitur në dokumentacionin e institucionit.</p> <p>Ev 33 _Trajnimet profesionale të mëtejshme-PP_TPD.pdf</p> <p>Ev. 12 _Rreg_ Funx. Zyrave ALUMNI UniBa.pdf</p> <p>Ev. 16 _Studim Tregu, PP_TPD.pdf</p> <p>Ev. 17.29 _Diplomimi&amp;punësimi i studentëve PP_TPD (Tab 23).pdf</p> <p>Ev. 32 _Institucionet Bashkëpunuese-PP_TPD(Tab 5).pdf</p> <p>Ev. 34 _Marreveshje Bashkepunimi per Praktiken Profesionale.pdf</p> <p>Ev. 35 _Raporti Periodik Analitik per Marreveshje Bashkepunimi.pdf</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Institucioni UniBa i paraqet studentëve një informacion të detajuar në funksion të realizimit të procesit mësimor. Informacioni mbi zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën, dhe shërbimet fillimisht vendoset në dispozicion nga koordinatori i departamentit, sekretaria mësimore dhe nga Dekani i studentëve. Ndryshimet në orare dhe zhvillimit të mësimi u jepen studentëve në dispozicion nga sekretaria mësimore. Informacionet e tjera në lidhje me procesin mësimor, kalendarin akademik dhe aktivitete të ndryshme mësimore qe organizohen në UniBa, u dërgohen nga Koordinatorin i Departamentit dhe Dekani i Studentëve.</p> <p>Komunikimet në pjesën më të madhe të tyre bëhen nëpërmjet sistemit të brendshëm të menaxhimit të studentëve. Të dhënat në</p>

	<p>këtë sistem rregjistrohen dhe përditësohen në kohe reale.</p> <p>Ev. 12_Rreg_Funx. Zyrave ALUMNI UniBa.pdf</p> <p>Ev. 26_Të dhëna për nr. e programeve(Tab 3).pdf</p> <p>Ev. 25_Të dhëna për ngarkesën mësimore(Tab 4).pdf</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>UniBa u ofron studentëve të gjitha të dhënat e nevojshme për mësimdhënien në kohë reale përmes sistemit të brendshëm të menaxhimit të tij. Studentët marrin informacion në lidhje me programin e studimit, lëndët përbërëse të tij në simestra dhe në vite akademike, kreditet e lëndëve. Të gjitha këto informacioni të përgjithshme për lëndët janë të ofruara dhe në faqen e internetit të UniBa. Njohja e studentëve me programet e lëndëve bëhet dhe në fillim të çdo simestri nga pedagogët e lëndëve të cilët prezantojnë syllabusin e lëndës. Syllabusi është i publikuar dhe në google classroom. Funkcionet që ofrohen nëpërmjet platforms se google classroom janë të ofruara dhe nëpërmjet sistemit të brendshëm të menaxhimit të studentëve. Këto të dhëna janë paraqitur dhe në dokumentacionin e fakultetit për punimit me google classroom për stafin akademik dhe studentët, në manualin e mësimdhënies online dhe në udhëzuesin për përdorimin e strukturs së TIK në UniBa. Gjithashtu një nga format e komunikimit të studentëve është nëpërmjet portalit studentor dhe gjithashtu dhe Intranetit si për studentet dhe për stafin akademik.</p> <p>Ev. 39. Manual i Mesimdhënies Online.pdf</p> <p>Ev. 46.1_Plani Udhëzues TIK.pdf</p> <p>Ev. 46.2_Manuali_Google_Classroom_Pedagogu.pdf</p> <p>Ev. 46.3_Manuali_Google_Classroom_Studenti.pdf</p> <p>Ev. 46.11_Komunikimet_Zyra_TIK.pdf</p> <p>Ev. 46.5_Manuali_Intranet.pdf</p> <p>Ev. 46.6_Portali_Studentor.pdf</p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përbushet</b></p>	<p><b>Përbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi V.3**

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit me karakter profesional, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në vitet paraardhëse në programin e studimit.</p>	<p>UniBa disponon dhe ka ruajtur statistika vjetore të detajuara për numrin e studentëve të cilat janë paraqitur dhe në dokumentacionin e paraqitur nga fakulteti. Këto statistika janë vënë në dispozicion dhe nga Sekretaria e fakultetit ku u kontrolluan dhe rregjistrat e rregjistrimeve, rregjistrat e notave dhe procesverbalet e ruajtura të</p>

	<p>studentëve që kanë qënë të rregjistruar në këtë program studimi. Në sekretari gjithashtu janë ruajtur dhe të dhëna te diplomimit të studentëve.</p> <p>Ev. 27.28_Regjistrimet, Ecuria, Nota Mesatare.pdf</p> <p>Ev. 17.29_Diplomimi&amp;punësimi i studentëve PP_TPD (Tab 23).pdf</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>UniBa disponon një bazë të dhënash në lidhje me studentët e regjistruar në këtë program studimi profesional. Edhe pse numri i studentëve ka qënë i ulët në database në Sekretarinë e fakuletit janë të ruajtura të gjitha të dhënat e studentëve për diplomimet, studentët e transferuar, studentët që kanë ndërprerë studime. Ky program studimi gjithashtu për këto dy vite nuk ka patur rregjistrime. Në sekretarinë e fakuletit u kontrolluan rregjistrat e lëndëve për këtë program studimi, rregjistrat e notave, rregjistrimi i studentëve dhe dokumentacionet e paraqitura nga studentët. Këto veprimtari janë përcaktuar dhe në rregulloren e funksionimit të sekretarisë mësimore.</p> <p>Ev. 27.28_Regjistrimet, Ecuria, Nota Mesatare.pdf</p> <p>Ev. 17.29_Diplomimi&amp;punësimi i studentëve PP_TPD (Tab 23).pdf</p> <p>Ev. 9_Rreg_per Funx. e Sekretarise Mesimore.pdf</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimit deri në diplomimin e tyre, përfshirë punësimin eventuale të tyre.</p>	<p>Institucioni disponon për çdo student të dhënat për ecurinë e studentëve nga momenti i rregjistrimit deri në diplomim. Të dhënat janë të regjistruara në rregjistrat që ndodhen në sekretari gjithashtu janë të hedhur dhe në sistemin e menaxhimit të brendshëm të fakuletit në formë elektronike. Ruajtja e të dhënave për çdo student bëhet në sekretarinë mësimore të fakuletit dhe gjithashtu këto procedura janë paraqitur dhe në rregulloren e sekretarisë. Kurse në zyrën Alumni dhe Karrierës janë ruajtur të dhënat që kanë të bëjnë me ecurinë e mëtejshme të studentëve, punësimin e tyre pas diplomimit. Kjo zyrë kryen pyetësorë të vazhdueshëm me studentët e diplomuar. GVJ gjatë vizitës në fakulet kontrolloi të dhënat që dispononte sekretaria e fakuletit dhe të dhënat që dispononte dhe zyra Alumni dhe Karrierës.</p> <p>Ev. 27.28_Regjistrimet, Ecuria, Nota Mesatare.pdf</p> <p>Ev. 17.29_Diplomimi&amp;punësimi i studentëve PP_TPD (Tab 23).pdf</p> <p>Ev. 9_Rreg_per Funx. e Sekretarise Mesimore.pdf</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e</p>	<p>Institucioni ka paraqitur që ka një sistem të brendshëm të menaxhimit në të cilin ka të regjistruar dhe të dhëna të studentëve. Të dhënat që janë hedhur në portalin studentore kanë memorje vetëm për një vit dhe nuk kanë database memorje. Sekretaria mësimore është njësi bazë në të cilën janë të ruajtura të dhënat e studentëve. Ajo nepermjet përdorimit të sistemit të brendshëm të informacionit për të dhënat e studentëve ka informacionet në kohë</p>

<p>autorizuar.</p>	<p>realë të ruajtura për sudentët. Për këto të dhëna janë ruajtur dhe statistika që janë paraqitur dhe në dokumentacionin e fakuletit. Portali studentor u mundëson atyre të informohen mbi notat dhe rezultatet e provimeve, datën e zhvillimit të provimit etj.</p> <p>Ev. 27.28_Regjistrimet, Ecuria, Nota Mesatare.pdf</p> <p>Ev. 17.29_Diplomimi&amp;punësimi i studentëve PP_TPD (Tab 23).pdf</p> <p>Ev. 9_Rreg_per Funx. e Sekretarise Mesimore.pdf</p> <p>Ev. 55_Raporti-Alumni-te-dhenat-statistikore.pdf</p> <p>4 Procesverbal i vleresimit semestral-vjetor.pdf</p> <p>Ev. 46.1_Plani Udhezues TIK.pdf</p> <p>Ev. 46.6_Portali_Studentor.pdf</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Institucioni UniBa ka paraqitur që realizon për çdo vit akademik një raportë analitikë. Ka të prezantuar cilësinë e studentëve, rezultatet e arritura prej tyre per vitet akademike që ka patur hyrje në fakultet, si dhe realizimin e objektivave të departamentit për këtë program studimi. Portali studentor brenda vitit akademik u mundëson që në kohë reale të kenë informacione në lidhje me ecurinë e studentëve dhe të rezulateve të tyre akademike. Të dhënat e studentëve, procesverbali i notave, regjistrat e prezencave, dhe të dhënat e tjera depozitohen në sekretari dhe më pas përpunohen nga ajo për tu paraqitur tek Dekani dhe Përgjegjësi i Departamentit.</p> <p>Ev. 27.28_Regjistrimet, Ecuria, Nota Mesatare.pdf</p> <p>Ev. 46.1_Plani Udhezues TIK.pdf</p> <p>Ev. 46.6_Portali_Studentor.pdf</p> <p>Ev. 38_Analize e PP_TPD.pdf</p> <p>Ev. 55_Raporti-Alumni-te-dhenat-statistikore.pdf</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi V.4</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe</p>	<p>UniBa ka paraqitur që studentët e vet i ka përfshirë në struktura përfaqësuese dhe vendimmarrëse. Ai inkurajon pjesëmarrjen e studentëve në vendimarrje, edhe në RVB njëri prej anëtarëve që kane punuar ishte student. Strukturat kryesore të institucionit ku janë të përfshirë student janë: Senati Akademik, Keshillimi i etikës dhe shanseve të barabarta, Komisioni i Sigurimit të Brendshem te</p>



<p>atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Standarteve të Cilësisë, Dekanatin e fakultetit, Këshillin Qeverinë studentore, Mbrehdjet e departamenteve etj. UniBa ka ambientet optimale për të patur organizime studentore të tilla si Klubet e studentore, Qeveria Studentore. Në mbështetje të studentëve janë dhe Zyra e Dekanit të studentëve që kryen funksionin monitories në procese të tilla vendimarrëse të institucionit.</p> <p>Ev 40. Pyetesor i Standard për studentët.pdf  Ev. 40.a_Guida per fokus grupin.pdf  Ev. 40_Formular vlerësimi i studentëve për lëndën.pdf  A.2 Urdher Për ngritjen e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm.pdf  Ev. 30_Të dhëna tab SSBC(Tab 24).pdf</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose e përfaqësuesve të tyre në vendimarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>UniBa ka paraqitur që ka përfshirë studentët e vet në njësi vendimarrëse. Mendimi i studentëve merret parasysh në këto organe vendimarrëse dhe ata njoftohen dhe marrin pjesë në mbledhjet e këtyre njësive. Ata përfshihen në vlerësimin e procesit akademik dhe bëhet sondazh i vazhdueshëm nga njësia e zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë dy herë në vit. Mblidhen të dhënat për secilën lëndë dhe secilin pedagogje dhe student kanë mundësinë të japin mendimin e tyre në lidhje me procesin e mësimdhënies. Gjithashtu një student i këtij programi studimi është i përfshirë dhe në grupin e RVB.</p> <p>Ev 40. Pyetesor i Standard për studentët.pdf  Ev. 40.a_Guida per fokus grupin.pdf  Ev. 40_Formular vlerësimi i studentëve për lëndën.pdf  A.2 Urdher Për ngritjen e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm.pdf  Ev. 30_Të dhëna tab SSBC(Tab 24).pdf</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Institucioni ka paraqitur në dokumentacionin e vet shpërndarjen e lëndëve dhe të krediteve në simestra. Cdo semester ka 30 kredite ECTS. Institucioni paraqet që pranon transferimet në bazë të Ligjit Nr. 80/2015 date 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucione e Arsimin të Lartë në Rep. e Shqipërisë”, udhëzimeve përkatëse të MASR-it dhe në përputhje me parimet e kartës së Bolonjës.</p> <p>UniBa pranon transferimet e studenteve në vitet ndërmjetëse nga shkollat e tjera të larta vendase ose të huaja, publike ose jopublike, dhe gjithashtu lejon transferimin e tij në shkollat e tjera të larta. Transferimet janë paraqitur dhe në procedurat e parashikuara në rregulloren e programit të studimit. Studentët janë gjithashtu të njohur me procedurat e njohjes dhe të ekuivalentimit apo shërbimeve të tjera dhe këto janë paraqitur dhe në Manualin përkatës që është dhënë si evidencë dhe janë të publikuara dhe në faqen e web-it të institucionit.</p> <p>Ev. 5_Rregullore e UniBa.pdf</p>

	<p>Ev. 54_Manual - Rekrutim-Aplikim-Regjistrim-Transferim.pdf  <a href="https://students.umb.edu.al/">https://students.umb.edu.al/</a>  <a href="https://students.umb.edu.al/sherbimet-studentore.html">https://students.umb.edu.al/sherbimet-studentore.html</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Institucioni UniBa garanton në dokumentacionin që ka paraqitur që studentët janë përfshirë në hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit. Studentët kanë qenverinë studentore në të cilin mund të paraqesin opinionet e tyre për programin e studimit. Gjithashtu janë pjesë e Senatit akademik, në të cilin mund të marrin pjesë në vendimarrje. Pyetesorët e studentëve ju lejonë të gjithë studentëve që të japin opinionin e tyre në komente dhe të kenë mundësi që të shprehin përmirësime ose ankesa që mund të kenë për programin e studimit. Njësia e zhvillimit të Kurrikulës dhe Cilësisë kyen anketime çdo semester, dy javë përpara mbarimit të tij, me secilin grup, çdo vit, dy herë në vit për të gjitha programet e studimit, për të gjitha lëndët dhe pedagogët e programit të studimit. Rezultatet e pyetësorëve përpunohen dhe përdoren nga njësitë bazë dhe nga pedagogët përkatës për të rishikuar lëndën dhe për të përmirësuar mësimdhënien. Më pas bazuar në këto vlerësime dhe nga vlerësimet e Njesise se Zhvillimit të Kurrikulës dhe Cilësisë bëhen dhe përmirësimet e niveleve të shërbimit në këtë program.</p> <p>Ev. 40_Formular vlerësimi i studentëve për lëndën.pdf  Ev. 41_Pyetesor i stafit akademik dhe ndihmes akademik.pdf  Ev. 5_Rregullore e UniBa.pdf  <a href="https://students.umb.edu.al/">https://students.umb.edu.al/</a></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësies/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Pyetësorë e studentëve ju lejon të gjithë studentëve që të japin opinionin e tyre në komente dhe të kenë mundësi që të shprehin përmirësime ose ankesa që mund të kenë për programin e studimit. Njësia e zhvillimit të Kurrikulës dhe Cilësisë kyen anketime çdo semester, dy javë përpara mbarimit të tij, me secilin grup, çdo vit, dy herë në vit për të gjitha programet e studimit, për të gjitha lëndët dhe pedagogët e programit të studimit. Rezultatet e pyetësorëve përpunohen dhe përdoren nga njesite bazë dhe nga pedagogët përkatës për të rishikuar lëndën dhe për të përmirësuar mësimdhënien.</p> <p>Mënyra e kontrollit të dijeve është një proces transparent e cila i bëhet e njohur studenteve që në javën e parë të semestrit dhe i prezantohet me syllabusin e lëndës.</p> <p>Gjithashtu mënyra e kontrollit te dijeve paraqitet dhe në rregulloren e Universitetit ose në rregulloren e programit të studimit.</p> <p>Ev. 5_Rregullore e UniBa.pdf  Ev. 6b_Rreg_Dept SHAK.pdf</p>

	Ev. 7_Rreg_PP - Prodhime Digjitale dhe Softëare.pdf Ev. 8_Rreg_Njesise se Zhy. te Kurrikul&Cilesise.pdf Ev. 40_Formular vlerësimi i studentëve për lëndën.pdf			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Natë përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët	
Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Institucioni ka paraqitur që ka procedura dhe njësi të posaçme në shërbim të studentëve të cilat veprojnë në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve. Njësitë e posaçme të UniBa janë Zyra e Pranimi, Sekretaria Mësimore, Dekani i Studenteve, Zyra e Alumni dhe e Karrierës dhe gjithashtu është dhe Koordinatori i Departamentit. Këto zyra ndjekin ecurinë e studentëve nga regjistrimi dhe deri në diplomimin e tyre duke ofruar shërbime këshillimi. Këto shërbime ofrohen direkte në UniBa por gjithashtu dhe në faqen e web-it të Institucionit.</p> <p>Një nga njësitë më kryesore është dhe Sekretaria Mësimore e cila ka dhe rregulloren e sekretarisë ku janë përfshirë proceset dhe asistimi studentëve.</p> <p>Ev. 9_Rreg_per Funx. e Sekretarise Mesimore.pdf Ev. 27.28_Regjistrimet, Ecuria, Nota Mesatare.pdf Ev. 12_Rreg_Funx. Zyrave ALUMNI UniBa.pdf Ev. 6b_Rreg_Dept SHAK.pdf <a href="https://students.umb.edu.al/">https://students.umb.edu.al/</a> <a href="https://students.umb.edu.al/sherbimet-studentore.html">https://students.umb.edu.al/sherbimet-studentore.html</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në institucion është ngritur dhe funksionon një sistem i posaçëm për mirëpritjen, informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Në institucion janë të ngritura disa njësi për mirëpritjen, këshillimin dhe informimin e studentëve. Sekretaria Mësimore dhe Koordinatori i departamentit mund të asistojnë në çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. Kurse Dekani i Studentëve dhe Zyra Alumni dhe e Karrierës mund të asistojnë për të marrë informacion dhe Këshillim për aktivitete e shërbime mbështetëse brenda dhe jashtë UniBa.</p> <p>Ev. 9_Rreg_per Funx. e Sekretarise Mesimore.pdf Ev. 36b_Detyrat e Koordinatorit.pdf Ev. 12_Rreg_Funx. Zyrave ALUMNI UniBa.pdf</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 59

<p><b>Kriteri 3.</b> Përmes zyrës/ njësisë për këshillimin e karrierës, institucioni mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm lidhur me plotësimin e detyrimeve të procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Insitucioni nëpërmjet njësisë të veta ofron mbështetje të vazhdueshme për këshillimin e karrierës dhe mirëpritjen e studentëve të vet. Në institucion janë të ngritura disa njësi për mirëpritjen, këshillimin dhe informimin e studenteve. Sekretaria Mësimore dhe Koordinatorit i Departamentit mund të asistojnë në çeshtje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. Kurse Dekani i Studenteve dhe Zyra Alumni dhe e Karrierës mund të asistojnë për të marrë informacion dhe Këshillim për aktivitete e shërbime mbështetëse brenda dhe jashtë UniBa.</p> <p>Ev. 9_Rreg_ per Funx. e Sekretarise Mesimore.pdf Ev. 36b_Detyrat e Koordinatorit.pdf Ev. 12_Rreg_ Funx. Zyrave ALUMNI UniBa.pdf</p>								
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit, ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse dhe merr masa për përmirësimin e shkallës dhe cilësisë së punësimit të tyre.</p>	<p>Zyra e Alumni dhe e Karrierës është ajo që ka për detyrë për të planifikuar shërbimet studentore në praktika dhe internshipe dhe gjithashtu për të mbështetur me tej karrierat e tyre profesionale. Ajo harton çdo vit plane vjetore me gjurmimin e studentëve dhe komunikimin e tyre të vazhdueshëm nëpërmjet adresave të email-it, të dhënave të kontaktit, adresave të rrjeteve sociale etj.</p> <p>Zyra Alumni dhe Karrierës ka organizuar dhe Barleti Alumni reunion, ku mbidhen alumni ndër vite.</p> <p>Ev. 12_Rreg_ Funx. Zyrave ALUMNI UniBa.pdf Ev. 5_Rregullore e UniBa.pdf</p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="660 1158 815 1234">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="820 1158 975 1234">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="979 1158 1134 1234">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1139 1158 1345 1234">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional “Teknik në Prodhime Digjitale dhe Software” të Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti “Barleti”**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Intitucioni UniBa ka një staf akademik me eksperiencë për këtë program studimi;
2. Instutucioni UniBa mbështet zhvillimin e stafit akademik dhe të përmirësimit të vazhdueshëm duke organizuar trajnime, workshop, konferenca dhe projekte në të cilat janë përfshirë anëtarët e stafit akademik.
3. Intitucioni UniBa ka dy kampuse kryesore dhe disa salla bibliotekash në suportin e mësimdhënies dhe mbështetjes së vazhdueshme të studentëve të tij dhe ka bërë abonime në disa biblioteka online.
4. Intitucioni UniBa disponon gjithë mundësitë dhe mjediset mësimore në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik për zhvillimin e mëtejshëm të tyre.

**Pika të dobta:**


1. Mungesa e disiplinave A dhe E në programin e studimit.
2. Raporti i shpërndarjes së lëndëve sipas disiplinave nuk është në përputhje me kornizën ligjore për programet e studimit me karakter profesional.
3. Mungesë e syllabuseve të rifreskuara për vitin akademik 2020-2021.
4. Mungesë e një studim tregu për të evidentuar qartë kërkesat e kompanive të biznesit dhe institucioneve në lidhje me studentët e diplomuar në këtë program studimi.
5. Pësia e praktikës profesionale nuk është e mjaftueshme me kërkesat e studentëve.
6. Hapja e programit të studimit një vit përpara pandemisë, ka ndikuar negativisht në vazhdimësinë e tij. Kjo ka qënë një nga pikat e dobëta që programi nuk ka patur mundësi që të marr promovimin e duhur.

**Rekomandime:**

1. GVJ gjen një mos – akordancë midis lëndëve në programin mësimor dhe përcaktimeve të dhëna nga korniza ligjore (VKM nr.897 datë 18.12.2019 dhe VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 për “Elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”). GVJ rekomandon një rishikim të programit mësimor, një shpërndarje të drejtë të lëndëve sipas kategorive të veprimtarive formuese. GVJ

rekomandon përfshirjen në programin mësimor të disipline “A” dhe “E” dhe reflektimin e tij edhe në Rregulloren e Programit mësimor nga ana e DSHAK.

2. GVJ rekomandon plotësimin e syllabuseve që i përkasin veprimtarisë formuese të kategorisë “C” dhe “D” dhe rishikimin e tyre duke konsideruar që disa prej tyre reflektojnë vitin akademik 2019/2020 ndërsa disa 2020/2021.
3. GVJ rekomandon edhe përmirësimin e formave të mësimdhënies dhe vlerësimit të studentëve. Inkurajimi i detyrave të kursit dhe punës në grup e konsiderojmë të rëndësishme në lëndët të përfshira në kategoritë “A”, “B” dhe “C”.
4. Insitucioni duhet të zhvillojë një plan të mëtejshëm zhvillimi për programin e studimit pasi nuk ka patur studentë për dy vite akademike.
5. Rishikim të programit mësimor dhe rritje të peshës së praktikës profesionale/ intershipit.
6. Të bëhet një studim i mirëfilltë i tregut të punës i cili do të evidentonte qartë kërkesat e kompanive të biznesit dhe institucioneve në lidhje me studentët e diplomuar në këtë program studimi. Rezultatet e një studimi tregu do të shërbejnë edhe si një shtysë për përmirësimin e programit të studimit dhe në rritjen e cilësisë dhe përmbajtjes së tij e cila do të sjellë në terma afatgjatë edhe një rritje të numrit të studentëve.



**Conclusions from the Evaluation of the study program with professional character “Technician in digital product and software” offered by Higher Education Institution (HEI) “Barleti”**

**Strengths and affirmations:**

1. The HEI “Barleti” has an experienced staff for this study programme.
2. The HEI “Barleti” supports the progress of the academic staff and their continuous improvement through involving the members of academic staff in trainings, workshops, conferences and projects organized by the institution.
3. The HEI “Barleti” has two main campuses and several library halls in support of the teaching and ongoing support of its students as well as has subscribed to several online libraries.
4. HEI “Barleti” has all the opportunities and teaching environments available to students and academic staff for their further development.

**Weak points:**

1. Lack of disciplines A and E in the organization of study program.
2. The ratio of course distribution in each discipline/ category is not in accordance with the legal framework defined for professional study programs.
3. Lack of updated syllabi for the academic year 2020-2021.
4. Lack of a market study to clearly identify the requirements of business companies and institutions regarding graduate students in this study program.
5. The load of professional practice/ internship is not sufficient to fulfill the student requirements;
6. Opening the study program one year before the pandemic has negatively affected its continuity and thus the inability of the study programme to get proper promotion has been considered and a weak point.

**Recommendations:**

1. The EEG noticed a discrepancy between the courses in the curriculum and the definitions given by the legal framework (DCM no. 897 dated 1812.2019 and DCM No. 41, dated 24.1.2018 on “Elements of study programs offered by HEIs”). GVJ recommends a curriculum review, a fair distribution of subjects according to the

categories of education activities. GVJ recommends the inclusion in the curriculum of the discipline "A" and "E" and its reflection in the Curriculum Regulation by DCSA.

2. GVJ recommends the completion of syllabi belonging to the group activity of category "C" and "D" and their review considering that some of them were reflecting the academic year 2019/2020 whilst the others respectively the year 2020/2021.
3. The EEG recommends the improvement in the forms of teaching and student assessment. The encouragement of course assignments and group work are considered important in the courses pertaining the disciplines/categories "A", "B" and "C".
4. The institution should develop a further development plan for the study program, as there have been no students for two academic years.
5. Curriculum review and increase the weight of professional practice/ internship.
6. To conduct a thorough research of the labor market which should clearly identify the requirements of business companies and institutions in relation to graduate students in this study program. The results of a market study will also serve as an impetus for improving the study program and increasing its quality and content, which will bring in the long term an increase in the number of students.





**Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
<b>I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL</b>				X
<b>II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL</b>		X		
<b>III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT</b>			X	
<b>IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE</b>				X
<b>V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE</b>				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>			X	

